



Lajmëtari informativ i Qytetit të Shkupit

SHKUPË

| Numër 25 | Viti V | 10.05.2012 |

Numër
falas





Koce Trajanovski
Kryetar i Qytetit të Shkupit

Të nderuar bashkëqytetarë,

Po kalojnë tre vite nga ardhja ime në funksionin Kryetar i Qytetit të Shkupit. Tre vite e kaluara jemi dëshmitarë se Shkupi çdo ditë rritet, zhvillohet dhe transformohet në një metropol të vërtetë evropian me bulevarde të gjera dhe të qarkullueshme, nivel të kënaqshëm të higjienës publike, parqe të gjelbra dhe vende pushimi dhe rekreacioni, monumente kulturore-historike dhe manifestime që ia vlen të vizitohen dhe të përjetohen, institucione efikase në dobi të qytetarëve... Kjo është detyra që unë dhe ekipi im vendosëm para tre vitesh, dhe para qytetarëve e premtuam në programin tonë zgjedhor i cili realizohet me sukses, hap pas hapi. Ky është trend që do ta mbajmë edhe vitin që është para nesh dhe do të vazhdojmë të lëvizim në rrugën e ndryshimeve pozitive.

Tre vitet e kaluara ekipet tona depërtuan dhe 9 000 metra rrugë dhe bulevarde të reja. Jam veçanërisht krenar për zgjerimin dhe rikonstruksionin e bulevardit "Ilinden" në qendrën e qytetit. Ky është bulevardi i parë i zgjeruar në qendrën e qytetit në 12 vitet e kaluara dhe që në ditët e para kontribuoi për zvogëlimin e kaosit që krijohet në këtë grykë të ngushtë komunikacionit rrugor. Jo më pak i rëndësishëm është zgjerimi i bulevardit "Mitropolit Teodosij Gologanov", me kryqëzim turbo rrethor, i pari i këtij lloji në vendin tonë. Këtu do të përmend edhe bulevardet e zgjeruara "Serbia" dhe "Video Smilevski Bato", "Sveti Kliment Ohridski" "Makedonska vojska" dhe unaza në rrugën "Gjorge Petrov" të cilat u

transformuan në lidhje të shpejta të komunikacionit rrugor me katër deri në gjashtë korsi, sinjalizim të ri rrugor, trotuare të rregulluara, ndriçim të ri dhe gjelbërim të mesëm.

Në disa aksione Qyteti i Shkupit nga viti 2009 e deri tani ka rinovuar rreth 17 000 metra rrugë automobilistike të dëmtuara nëpër qytet. Gjashtë rrugë automobilistike kryesore në qendrën e qytetit morën pamje të re: bulevardet "Partizanski odredi", "Krste Misirkov" dhe "Kuzman Josifovski Pitu", dhe në rrugët "Dame Gruev", "Vasil Axhillsarski" dhe "Stiv Naumov". Asfalti i dëmtuar u rinovua në rrugët "Kozle", "Radishanska", "Krushopek", "Ivan Kozarov", "Kemal Sejfulla", në rrugën Kopanicë – Rashçe, "Volkovska", në disa rrugë në lagjen Usje, në rrugën "Bilagoja Stefkovski", "Belgradska", "Pere Toshev", "Juzhnomoravski brigadi", si dhe në rrugën për Hipodrom, Vizbeg dhe për Inxhikovë.

Përveç përpjekjeve për zvogëlimin e kaosit në komunikacionin rrugor në qytet, që është një nga prioritet të punën time, mendojmë edhe për sigurinë e këmbësorëve. Në rrugën regjionale Shkup – Katlanovë për herë të parë u ndërtua trotuar, kurse trotuar për herë të parë u ndërtua edhe në rrugën Skupi. Në aksionin e madh u rinovuan edhe trotuaret përgjatë gjashtë rrugëve automobilistike kryesore në qendrën e qytetit.

Me ndërtimin e parkingjeve të reja Qyteti i Shkupit në vitet e kaluara ndikoi në mënyrë të drejtpërdrejtë në zgjidhjen e problemit me mungesën e vendeve për parkim në qytet. Shkupi u bë me 1 000 vende parkimi të reja në parkingjet nën Qendrën transportuese, tek Kopshti zoologjik, tek ndërtesa e RTVM, tek QT "Mavrovka" dhe në lagjen Aerodrom. Ndërtimi i dy garazheve me kate, në rrugën "Mito Haxhivasiljev Jasmin" dhe në rrugën "Dame Gruev" është në vijim, kurse me hapjen e tyre do të merren 1 000 vende parkimi plotësuese.

Ndërmarrjet publike në të cilat vite me radhë nuk është investuar në tre vitet e fundit përjetuan rilindje. NP "Higjiena komunale" e gjetëm vetëm me 6 automjete të vjetra. Për të përmirësuar punën e kësaj ndërmarrje publike blemë 40 kamion për ngritjen e mbeturinave, Ndërmarrjen publike "Parqe dhe gjelbërim" e rinovuam me 40-të makina dhe automjete, kurse makina të reja dha bazë asfalti mori NP "Rrugë dhe rugica". Realizuam aksione të rregullta për pastrimin e sipërfaqeve publike të qytetit, dhe vendosëm rregull në punën e ndërmarrjeve publike. Higjienën publike në qytet e ngritëm në nivel më të lartë, dhe qytetarët e shikojnë ndryshimin.

Aksioni për gjelbërimin e Shkupit është një nga më të rëndësishmit e Qytetit të Shkupit në tre vitet e fundit. Në sipërfaqet publike u mbollën 42 000 fidanë, kurse në katër aksione ndamë 10 000 drurë në institucionet publike, këshillat banesor dhe institucionet arsimore. Me gjelbërim rregulluam 8 000 metra zhardhinierë të mesëm në bulevarde, dhe po rregullohen edhe sipërfaqet e parqeve. Rregullisht janë pyllëzuar territoret e Vodnos dhe Gazi Babës, si dhe Parku i qytetit.

Për herë të parë hapa çështjen për ndotjen e ajrit të Shkupit dhe vendosëm stacione matëse me ekran që tregojnë vlerat e materieve ndotëse. Institucionet kompetente i thërrita në aksion të përbashkët për të paraqitur burimet e ndotjes së ajrit dhe për të marrë të gjitha masat e domosdoshme që t'u mundësohet qytetarëve jetë e shëndetshme dhe me kualitet.

Në tre vitet e kaluara krijuam kushte që qytetarët të relaksohen në bregun e lumit Vardar, pikërisht ndërtuam korsi patinash-biçikletash, vendosëm rekuizite sportive dhe terrene voleybolli. Dy vjet punojmë në rinovimin e ndërtesave të shkollave të mesme të Qytetit të Shkupit gjë me të cilën përmirësuam kushtet për zhvillimin e procesit mësimor.

Dua të potencoj se për një numër të madh projektesh Qyteti i Shkupit kishte ndihmën altruiste nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, dhe këtu do të theksoj në veçanti blerjen e autobusëve të rinj për NQP "Shkup", ndërtimin e teleferikut në Vodno, blerjen e 60 000 kazanëve individual për mbeturinara që iu ndanë falas qytetarëve, ndihmën gjatë ndërtimit të kolektorit fekal për Inxhikovën...

Në këto disa rreshta nuk mund të numërohen të gjitha projektet e realizuara në të cilat punuam me vetëmohim tre vitet e kaluara. Ne nuk do të ndalemi këtu, vazhdojmë me të njëjtën tempo. Për këtë vit kemi planifikuar shumë projekte të cilat do të kontribuojnë që Shkupi të shndërrohet në qytet modern dhe funksional. Së bashku me qytetarët të cilët komentojnë rregullisht projektet tona gjejmë zgjidhje të reja, dhe shikojmë gabimet dhe përmirësime projektet. Kjo, mendoj se është kyçi për sukses për çdo kryebashkiak, për çdo ekip.

Unë dhe ekipi im në periudhën e ardhshme do të punojmë në realizimin e programit tim zgjedhor për të cilin qytetarët e Shkupit më dhanë besimin e tyre, dhe që garanton kushte më të mira për jetesë në qytet të cilin e quajmë shtëpinë tonë.



„SHKUP“

LAJMETARI INFORMATIV I
QYTETIT TË SHKUPIT

Numri i parë i lajmëtarit informativ
„Shkupi“ u botua më:
10 dhjetor 2008

Kryeredaktor
Nedelço Krstevski

Redaksia

Seksioni për marrëdhënie me
opinionin

Redaktor i fotografi së
Radomir Jovanović

Përkthyes dhe lektor
Vladimir Bogdanovski

BOTON QYTETI I SHKUPIT
për botuesin
Kryetari i Qytetit
Koce Trajanovski
Bulevardi Ilindenska p.n.

Telefon

02 3297 255

e-mail adresa

gragjani@skopje.gov.mk

Dizajni

NAMPRES - Shkup

Botoi

NAMPRES - Shkup



Projekte kapitale të Qytetit të Shkupit

PO NDËRTOHET BULEVARDI "PRVOMAJSKA"

Punët ndërtimore për zgjerimin dhe rikonstrukcionin e rrugës "Prvomajska" në komunën Kisela Voda, janë në vijim. Kjo grykë e ngushtë e komunikacionit deri në fund të vitit do të transformohet në bulevard, me katër korsi rrugore, trotuare të rregulluara, gjelbërim dhe ndriçim të ri.

- Rruga "Prvomajska, në komunën Kisela Voda, është një nga arteriet më të mëdha dhe të rëndësishme të komunikacionit rrugor në Shkup nga e cila varen në mënyrë të drejtpërdrejtë më shumë se 150.000 banorë të qytetit tonë. Për projektin voluminoz për zgjerimin dhe rikonstrukcionin e rrugës "Prvomajska" punuam me vetëmohim 2,5 vjet. Pas përfundimit të saj, do të mbeten në të kaluarën radhët e gjata të automobilave, kaosi dhe lëvizja e vështirësuar që tani janë një pamje e zakonshme në këtë rrugë me frekuencë të madhe. Rruga "Prvomajska" me gjatësi 2,5 kilometra do të transformohet në një bulevard të gjerë dhe të qarkullueshëm, me trotuare të rregulluara dhe me gjelbërim anësor dhe do të vërtetohet përpjekjet e Qytetit të Shkupit për zgjidhjen e problemit me kaosin


në komunikacionin rrugor dhe, që është më e rëndësishme, do të rrisë sigurinë për të gjithë pjesëmarrësit në qarkullimin rrugor – tha kryetari Trajanovski, në fillim të punëve ndërtimore të rrugës.

Me këtë projekt do të bëhet rikonstrukcioni i dy pjesëve të rrugës "Prvomajska" dhe atë:

- Pjesa 1: Nga „Rampa“ deri në kryqëzimin me rrugën "Narodni heroj" me gjatësi 1.380 metra dhe

- Pjesa 2: Nga kryqëzimi me bulevardin "Serbia" deri në hyrjen e fabrikës „Staklarnica“ me gjatësi 1.126 metra.

Gjatë punëve ndërtimore në të dy pjesët e rrugës "Prvomajska" do të vendoset kanalizimi atmosferik me profil të ndryshueshëm. Ura ekzistuese prej betoni të armuar mbi kanalin Usjanski di të rinovohet, do të zgjerohet dhe do



të ketë 4 korsi rrugore me korsi për këmbësorë dhe për biçikleta.

Në zgjerimin dhe rinovimin e rrugës "Prvomajska" do të punojnë ekipet e konzorciumit „Alpine Bau“ dhe Zhikol nga Shkupi. Punët ndërtimore duhet të përfundojnë për nëntë muaj. Në projektin për zgjerimin dhe rinovimin e rrugës "Prvomajska", Qyteti i Shkupit do të investojë rreth 4 milion euro, para të siguruar nga Banka evropiane për rinovim dhe zhvillim dhe nga Buxheti i Qytetit të Shkupit.



BULEVARDI "ILINDEN" MORI PAMJE TË RE

Zgjerimi dhe rinovimi i rrugës "Ilindenska" është një nga projektet më të mëdha të realizuara në territorin e qendrës së qytetit në 12 vjetët e fundit. Rruga "Ilindenska" u transformua në bulevard "Ilinden" në drejtimin nga kryqëzimi me bulevardin "Sveti Kliment Ohridski" deri te pompa e benzinës "Makpetrol", me gjatësi 2 420 metra. Bulevardi u bë me dy korsi në çdo drejtim, trotuar të rregulluar dhe korsi për biçikleta, kryqëzime të reja, gjelbërim të mesëm dhe ndriçim të ri kursyes.

Në vitin 2010 u zgjerua pjesa e bulevardit "Ilinden" nga kryqëzimi me bulevardin "Sveti Kliment Ohridski" deri në kryqëzimin me bulevardin "8. Shtetëmi" me gjatësi 2 140 metra. Për realizimin e këtij projekti të ndërlikuar Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 3,3 milion euro.



Në vitin 2011 u depërtua pjesa e dytë e bulevardit "Ilinden" nga kryqëzimi me bulevardin "8. Shtetëmi" deri te pompa e benzinës

"Makpetrol", me gjatësi 280 metra. Në realizimin e kësaj pjesë të projektit Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 20 milion denarë.



KRYQËZIM TURBO RRETHOR NË BULEVARDIN “MITROPOLIT TEODOSIJ GOLOGANOV”

Me realizimin e suksesshëm të projektit kapital për zgjerim dhe rikonstrukcion në tetor të vitit 2011, në bulevardin “Mitropolit Teodosij Gologanov” u formua kryqëzim turbo rrethor, i pari këtij lloji në Shkup. Në kryqëzim u ndërtuan 4 korsi rrugore, trotuare të reja dhe korsi për biçikleta, kurse u vendos edhe ndriçim i ri dhe gjelbërim.

Zgjerimi i rrugës ekzistuese u zhvillua në drejtimin nga rruga “Franklin Ruzvelt” deri te rruga “Kosturski heroj” (një pjesë) dhe drejt rrugës “Mito Haxhivasilev Jasmin” deri te kthesa djathtas drejt rrugës “Naroden Front” (pjesa e dytë), me gjatësi të përgjithshme 1 600 metra. Rruga automobilistike e re në bulevardin “Mitropolit Teodosij Gologanov” është asfaltuar në një sipërfaqe prej rreth 20 000 metra katror, ku shtresa përfundimtare e asfaltit është prej polimeri i cili ngadalëson amortizimin e asfaltit dhe formimin e gjurmëve nga lëvizja e automobilitave.

Realizimi i këtij projekti kapital në një masë të madhe kontribuoi për zgjidhjen e problemeve në territorin e qendrës së qytetit, për rritjen e qarkullimit të automjeteve dhe për zvogëlimin e kohës së udhëtimit, që kontribuon edhe për mbrojtjen e ambientit jetësor.

Në zgjerimin dhe rikonstrukcionin e bulevardit “Mitropolit Teodosij Gologanov” punuan ekipet e firmës ndërtimore „Bauer BG”, kurse për këtë projekt Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 96 milion denarë.



U PËRFUNDUA BULEVARDI “SERBIA”



Bulevardi “Serbia” në vitin 2011 u bë me 5 korsi rrugore, trotuare, korsi për biçikleta, gjelbërim të mesëm dhe ndriçim të ri. Gjatësia e pjesës së ndërtuar të re është 2 000 metra, nga kryqëzimi me bulevardin “Vidoe Smilevski Bato” deri te rruga “Prvomajska”. Në kryqëzimin me hyrjen në fabrikën „Usje” është formuar unazë e cila do të mundësojë qarkullim rrugor të pandërprerë.

Realizimi i këtij projekti të rëndësishëm kontribuoi për komunikim më të mirë ndërmjet komunave Aerodrom, Kisela Voda dhe Gazi Baba.

Për ndërtimin e këtij projekti kapital Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth dy milion euro.

U ZGJERUA BULEVARDI “VIDOE SMILEVSKI BATO”



Bulevardi “Vidoe Smilevski Bato”, në lagjen Novo Lisiçe në vitin 2009 u zgjerua në gjatësi prej 510 metra nga kryqëzimi me bulevardin “Serbia” deri te kryqëzimi me bulevardin “Fevruarski pohod”. Për punët ndërtimore u shpenzuan 30 milion denarë.

Bëhet fjalë për një zgjidhje moderne bulevardi, me kanalizim atmosferik të ndërtuar, llamba ndriçuese kursyese, brez gjelbërimi të mesëm dhe trotuare të regulluara.


GJASHTË KORSI PËR BULEVARDIN “SVETI KLIMENT OHRIDSKI”

Nga kryqëzimi me rrugën “Mito Haxhivasilev Jasmin” deri te kryqëzimi me bulevardin “Partizanski odredi”, në gjatësi prej 524 metra, në bulevardin “Sveti Kliment Ohridski” në shtator të vitit 2011 u ndërtuan gjashtë korsi, trotuare të reja dhe gjelbërim i mesëm.

Me projektin për zgjerimin dhe rikonstrukcionin e bulevardit “Sveti Kliment Ohridski” janë rregulluar edhe kryqëzimet ekzistuese, kurse në kryqëzimin me bulevardin “Partizanski odredi” janë shkurtuar ishujt e këmbësorëve, gjë me të cilën në bulevardin “Partizanski odredi” u ndërtua edhe korsa e tretë rrugore në drejtimin nga qendra e qytetit.

Gjatë punëve ndërtimore instalimet ekzistuese nëntokësore janë dislokuar nën trotuare, kurse tubi i ujësllësit është mbrojtur tërësisht me konstrukcion betoni të armuar. Për përcjelljen e ujërave atmosferik nga rruga e re automobilistike janë ndërtuar 42 vend derdhje plotësuese.

Në terren punuan ekipet e kompanisë së ndërtimit „Granit”. Për realizimin e këtij projekti kapital Qyteti i Shkupit ndau rreth 37 milion denarë.





BULEVARDI “MAKEDONSKA VOJSKA” U DEPËRTUA DERI TE STADIUMI

Pjesa e dytë e bulevardit “Makedonska vojska” gjatë vitit 2011 u depërtua deri te kryqëzimi me rrugën “Gjorçe Petrov” drejt stadiumit të KF „Makedonija Gjorçe Petrov” me gjatësi 850 metra.

Rruga automobilistike është e gjerë shtatë metra, janë formuar trotuare të shtruara me pllaka begatoni dhe ndriçim i ri rrugor.

Në ndërtimin e pjesës së bulevardit “Makedonska vojska” punuan ekipet e kompanisë së ndërtimit SHA „Granit”, kurse Qyteti i Shkupit për realizimin e këtij projekti kapital shpenzoi rreth 25 milion denarë.



UNAZË NË GJORÇE PETROV

Rrugët "Gjorçe Petrov", "Voin Drashkoci" dhe "Radushka", në komunën Gjorçe Petrov, në maj të vitit 2011 u lidhën me unazë. Unaza ka dy korsi rrugore të gjera 7 metra dhe korsi të reja për këmbësorë dhe biçikleta të shtrua me pllaka begatoni. Në unazë janë vendosur edhe shenja të reja të komunikacionit rrugor.

Qyteti i Shkupit me këtë zgjidhje të re komunikacioni kontribuoi në mënyrë të ndjeshme që të zvogëlohet kaosi në komunikacionin rrugor që ishte një pamje e zakonshme në rrugën "Gjorçe Petrov" dhe të rritet qarkullimi i automjeteve.

Në ndërtimin e kësaj unaze moderne punuan ekipet e kompanisë "Pelagonija-Gostivar".





Po bëhen përgatitje për rregullimin e hapësirës

RRUGË AUTOMOBILISTIKE NËNTOKËSORE PRAPA STACIONIT TË VJETËR HEKURUDHOR

Qyteti i Shkupit më 12 mars lidhi kontratë me kompaninë „Limak“ nga Republika e Turqisë me të cilën rregullohen marrëdhëniet për ndërtimin e rrugës automobilistike nëntokësore në përputhje me Planin detajues urbanistik „Stacioni i vjetër hekurudhor“.

- Kompania „Limak“ do të ndërtojë rrugën e re automobilistike nëntokë, në thellësi prej 6 metrash. Bulevardi do të jetë i gjatë 800 metra dhe do të ketë nga tre korsi rrugore në çdo drejtim. Pritet që punët ndërtimore për rrugën automobilistike nëntokësore të fillojnë për një vit. Në fillim do të ndërtohet bulevardi, kurse pastaj edhe objektet që do të ndërtohen mbi të - objekte për strehim kolektiv, qendra tregtare dhe afariste dhe hotele. Me këtë kontratë praktikisht fillon realizimi i projektit „Juzhen bulevar“ në Shkup. Qyteti i Shkupit në periudhën e ardhshme do të fillojë të bëjë projekte për vazhdimin e rrugës



automobilistike nëntokësore dhe lidhjen e saj me bulevardin „Mitropolit Metodij Gologanov“ - tha kryetari Trajanovski në nënshkrimin e kontratës.


Kompania „Limak“, sipas kontratës, pasi të ndërtojë rrugën automobilistike nëntokësore ka si obligim t'ia japë nën sundim Qytetit të Shkupit.



në emër të shtëpisë projektuese IDOM,
Hoze Alberto Fuldain.

- rrugor është 5,2 milion denarë me revizion. Vitin e kaluar me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë dhe Ministrinë e transportit dhe lidhjeve nënshkruam Memorandum për bashkëpunim për financimin e ndërtimit të kësaj rruge automobilistike e cila parashikohet të kushtojë rreth 32 milion euro. Përgatitja e projektit rrugor dhe ndërtimor pritet të përfundojë deri në fund të vitit 2012. Pastaj do të shpallet tender për zgjedhjen e realizuesit, kurse ndërtimi duhet të fillojë deri në fund të vitit 2013. Afati për realizim është 3 vjet – sqaroi kryetari Trajanovski.

Ai shtoi se gjatësia e rrugës automobilistike nëntokësore është 1300 metra, nga të cilat 900 metra janë nën tokë, kurse 400 metra mbi tokë. Rruga automobilistike fillon me unazë tek ura „Goce Delçev“, pastaj lëviz nën tokë dhe del në afërsi të Qendrës transportuese, ku duhet të bëhet edhe një unazë në kryqëzimin e bulevardit “Krste Misirkov” me bulevardet “Koço Racin” dhe “Kuzman Josifovski Pitu”. Rruga automobilistike nëntokësore do të ndërtohet 10 metra nën tokë.



ASFALT I RI PËR GJASHTË RRUGË TË MËDHA AUTOMOBILISTIKE

Bulevardet "Partizanski odredi", "Krste Misirkov" dhe "Kuzman Josifovski Pitu" si dhe rrugët "Dame Gruev", "Vasil Axhillarski" dhe "Stiv Naumov" në qershor të vitit 2011 u shtruan me asfalt të ri. Në aksionin e Qytetit të Shkupit shtresa e asfaltit të vjetër dhe të dëmtuar e këtyre rrugëve automobilistike u gërrye, pusetat dhe vend derdhjet u niveluan, u rregulluan stacionet e autobusit dhe u shtrua asfalt i ri.

Për realizimin e punëve ndërtimore të gjashtë rrugëve Qyteti i

Shkupit ndau rreth 150 milion denarë.

Në rinovimin e bulevardit "Partizanski odredi" dhe rrugës "Dame Gruev" punuan ekipet e NN "Pelagonija – Gostivar", kurse rrugët, "Vasil Axhillarski" dhe "Stiv Naumov" i rinovuan ndërtimtarët e "Hulusi komerc". Asfaltin në bulevardin "Krste Misirkov" e rinovuan ekipet e firmës së ndërtimit "Bauer BG", kurse në rikonstruksionin e bulevardit "Kuzman Josifovski Pitu" tek Stacioni hekurudhor, punuan ekipet e NP "Rrugë dhe rrugica".



Bulevardi „Kuzman Josifovski Pitu“



Bulevardi „Partizanski odredi“



Rruga „Stiv Naumov“



Rruga „Vasil Axhillarski“



Bulevardi „Krste Misirkov“



Rruga „Dame Gruev“

U RINOVUAN RRUGËT AUTOMOBILISTIKE NË KOMUNAT...



... KARPOSH

Ekipet e Qytetit të Shkupit vitin e kaluar përfunduan fazën e parë të rikonstruksionit të rrugës "Kozle" në komunën e Karposhit. Kjo rrugë me gjatësi 444 metra u shtrua me asfalt të ri dhe u ndërtuan trotuare të reja, në drejtimin nga stacioni i fundit i autobusit me numër 57 deri te kryqëzimi me rrugën "Jurij Gagarin".

Në rinovimin e rrugës "Kozle" punuan ekipet e kompanisë së ndërtimit "Pelagonija – Gostivar", kurse Qyteti i Shkupit për punët ndërtimore ndau rreth 11,5 milion denarë.



... SARAJ

Në qershor të vitit 2011 u bë rikonstruksioni i rrugës në fshatin Krushopek, në komunën e Sarajit. Pjesa e rrugës është e gjatë 1 200 metra dhe e gjerë 4,5 metra.

Në rikonstruksionin e rrugës në Krushopek punuan ekipet e kompanisë së ndërtimit "Pelagonija – Gostivar". Ky projekt është rezultat i bashkëpunimit të mirë ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe komunës së Sarajit. Për rinovimin e rrugës në Krushopek janë shpenzuar 14 milion denarë, kurse Qyteti i Shkupit mori pjesë me 8,5 milion denarë.



... BUTEL

Në komunën e Butelit, u shtrua me asfalt të ri rruga "Radishanska" me gjatësi 700 metra, nga hyrja e parë deri në hyrjen e tretë në lagjen Radishani.

Rrugën automobilistike "Radishanska" e rinovuan ekipet e kompanisë së ndërtimit "Hulusi komerc", kurse për rikonstruksionin Qyteti i Shkupit investoi rreth 10 milion denarë.



... KISELA VODA

Në rrugën "Ivan Kozarov" në lagjen Kisela Voda në vitin 2010 u ndërtua rrugë e re automobilistike me gjatësi 340 metra. Rrugë automobilistike u rinovua në drejtimin nga kryqëzimi me rrugën "Dositej Obradović" deri te kryqëzimi me rrugën "Bozhidar Axhija" kurse Qyteti i Shkupit për punët ndërtimore shpenzoi rreth 3 milion denarë.



... GJORÇE PETROV

Asfalt i ri vitin e kaluar u shtrua në rrugën "Volkovska", në drejtimin nga qendra e vendbanimit Volkovë deri te stacioni i fundit i autobusit me numër 22. Rruga automobilistike është zgjeruar dhe rinovuar në gjatësi prej 1 300 metra. Kjo pjesë është vazhdim i pjesës së rinovuar të rrugës "Volkovska", me gjatësi 1 700 metra, nga hekurudha deri te qendra e lagjes Volkovë, të cilën Qyteti i Shkupit e përfundoi në vitin 2010.

Qyteti i Shkupit në këtë projekt investoi rreth 28 milion denarë.



... SHUTO ORIZARE

Me asfalt të ri u shtrua edhe rruga "Pelagonija" në komunën Shuto Orizare. Rruga automobilistike është rinovuar në gjatësi 550 metra për të cilën Qyteti i Shkupit ndau 3,2 milion denarë.

Punët ndërtimore i realizoi ndërmarrja publike „Rrugë dhe rrugica“.



... KISELA VODA

Disa rrugë në lagjen Usje, të cilat para shumë vitesh ishin gërmuar për shkak të vendosjes së rrjetit të ujësjellësit, u shtruan me asfalt të ri. U zgjerua dhe u asfaltua rruga numër 1, me gjatësi 400 metra, si dhe rrugët numër 2, numër 3, numër 4 dhe numër 22 me gjatësi të përgjithshme 600 metra.

Qyteti i Shkupit për këtë projekt ndau 3,3 milion denarë, kurse në terren punuan ekipet e NP „Rrugë dhe rrugica“.



...GAZI BABA

Edhe rruga "Blagoja Stevkovski", në lagjen Maxhari, në vitin 2010 u shtrua me asfalt të ri. U rinovuan 800 metra të kësaj rruge, në drejtimin nga hyrja në Maxhari deri te mbikalimi drejt lagjes Çento. Në këtë punë ndërtimore në rrugën "Blagoja Stevkovski" u ndërtua kanalizim i ri atmosferik, me profil 800 milimetra.


Për rinovimin e kësaj rruge Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 26 milion denarë.



... BUTEL

Në korrik të vitit 2010 u rinovua rruga "Ferid Bajram", me gjatësi 800 metra. Me këtë u rrit qarkullimi i automjeteve në këtë rrugë automobilistike dhe u rrit siguria për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacionin rrugor.

Rikonstruksioni i rrugës "Ferid Bajram" Qytetit të Shkupit i kushtoi 6,5 milion denarë.



... SARAJ

Rrugë e asfaltuar në vitin 2009 u ndërtua ndërmjet fshatrave Kopanicë dhe Rashçe, në komunën e Sarajit. Pjesa e rinovuar e rrugës është e gjatë 698 metra me gjerësi 3,8 metra.

Rinovimi i kësaj rruge lehtësoi qasjen e banorëve të të dy fshatrave deri në Shkup, dhe mundësoi lidhjen me unazën Shkup – Tetovë. Për rikonstruksionin e rrugës Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 5 milion denarë.



... ÇAIR

Qyteti i Shkupit në vitin 2010 shpenzoi rreth 11,4 milion denarë për rikonstruksionin e plotë të rrugës "Kemal Sejfulla" në lagjen e Çairit.

Asfalti i vjetër u zëvendësua me safat të ri dhe rruga mori pamje krejtësisht të re.



... QENDËR

Punët ndërtimore në rrugët qarkore tek arena nacionale „Filipi II i Maqedonisë“ janë në vijim. Investimi është me vlerë rreth 35 milion denarë, në të cilin me nga një të tretën e mjeteve marrin pjesë Qyteti i Shkupit, SHA për ndërtimin dhe menaxhimin me hapësirën banesore dhe afariste dhe komuna Qendër.

Projekti për ndërtimin e rrugëve qarkore tek stadiumi përfshin ndërtimin e rrjetit atmosferik me gjatësi 550 metra, rrugë automobilistike me gjatësi 14 310 metra katror, trotuare me sipërfaqe 5 832 metra katror, si dhe ndriçim të plotë.



... GAZI BABA

Ekipet e Qytetit të Shkupit dhe të NP „Rrugë dhe rrugica“ asfaltuan rrugën drejt lagjes Hipodrom, nga hekurudha në Maxhari deri te qendra sportive në Hipodrom. Rruga është e gjatë 1 100 metra.

Për këtë vepër ndërtimore Qyteti i Shkupit investoi rreth 4 milion denarë.



... GAZI BABA

Edhe rruga për në lagjen Inxhikovë në komunën Gazi Baba u shtrua me asfalt ri, në drejtimin nga Fshati i fëmijëve SOS deri te ura në Inxhikovë. Rruga është e gjatë 420 metra, kurse për punët ndërtimore Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 1,2 milion denarë.



... BUTEL

Në vendbanimin Vizbeg u asfaltua rruga lokale me gjatësi 900 metra dhe është vendosur ndriçim i ri rrugor. Ndërtimi i rrugës kushtoi 12 milion denarë nga të cilat 50 % janë mjete të Qytetit të Shkupit, kurse 50 % të komunës së Butelit.



... GJORÇE PETROV

Rrugë e gjatë 846 metra lidhi vendbanimin Vizbeg me unazën veriore. Rruga automobilistike është me dy korsi me gjerësi 3,5 metra dhe trotuare me gjerësi 2,5 metra.

Për ndërtimin e kësaj rruge hyrëse nga arka e qytetit u ndanë 12 milion denarë.



... QENDËR

Qyteti i Shkupit dhe NP „Rugë dhe rrugica“ rinovuan rrugën „Belgradska“, nga kryqëzimi me rrugën „Vodnjanska deri në rrugën „Dimitar Mitrev“ me gjatësi 550 metra. Qyteti i Shkupit në këtë vepër ndërtimore investoi rreth 5 milion denarë.



... ÇAIR

Rruga automobilistike „Pere Toshev“, në Çair, vitin e kaluar u rinovua në gjatësi prej 180 metra dhe tani është e gjerë 6 metra. Për këtë vepër ndërtimore Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 1,8 milion denarë, kurse në terren punuan ekipet e kompanisë së ndërtimit „Bauer BG“.

Me rinovimin e rrugës „Pere Toshev“, Qyteti i Shkupit zgjidhi problemet shumëvjeçare të banorëve të tij, dhe rriti sigurinë në komunikacionin rrugor.



... SHUTO ORIZARE

Me kërkesë të banorëve përreth Qyteti i Shkupit asfaltoi rrugët „17“, „19“, „30“ dhe „33“, në komunën Shuto Orizare. Për realizimin e këtij projekti Qyteti shpenzoi rreth 12 milion denarë.



... GAZI BABA

Në gjatësi prej 756 metra dega e rrugës „Juzhnomoravski brigadi“ që të çon drejt varrezave Kamnik u zgjerua dhe u rinovua. Rruga tani ka dy korsi rrugore dhe trotuare të reja.

Për realizimin e këtij projekti, i cili është investim i Qytetit të Shkupit dhe i komunës së Gazi Babës, u investuan rreth 23,5 milion denarë, nga të cilat Qyteti i Shkupit siguroi 75 %. Në terren punuan ekipet e kompanisë së ndërtimit „Bauer BG“.

U NDËRTUAN TROTUARE NË RRUGËN REGJIONALE SHKUP-KATLANOVË...

Përgjatë rrugës Shkup –Katlanovë (P-303), nëpër vendbanimin Trubarevo, në vitin 2010 për herë të parë u ndërtua trotuar gjë me të cilën u rrit në mënyrë të ndjeshme siguria e këmbësorëve dhe çiklistëve.

Në ndërtimin e trotuareve në Trubarevo punuan ekipet e NP „Rrugë dhe rrugica“. Kjo punë ndërtimore Qytetit të Shkupit i kushtoi rreth 3 milion denarë.



...NË RRUGËN SKUPI...

Trotuar i ri është ndërtuar përgjatë rrugës „Skupi“, në drejtimin nga lumi Lepenec deri në rrugën Bardovci, me gjatësi 800 metra. Në rrugën „Skupi“ më parë nuk kishte trotuar. Me këtë projekt të Qytetit u rrit siguria e këmbësorëve në rrugën „Skupi“. Për ndërtimin e trotuarit Qyteti i Shkupit shpenzoi 3,2 milion denarë.



...DHE NË BULEVARDIN NIKOLLA KAREV

Përgjatë bulevardit „Nikolla Karev“, nga poliklinika „Bit-pazar“ drejt hotelit „Kontinental“, në vitin 2010 për herë të parë u ndërtua trotuar.

Korsia për këmbësorë është ndërtuar edhe nga ana tjetër e bulevardit, nga kryqëzimi „Tërfil“ deri te kryqëzimi tek hoteli „Kontinental“, me gjatësi 500 metra.

Në terren punuan ekipet e NP „Rrugë dhe rrugica“.

U RINOVUAN TROTUARET NË QENDËR

Trotuaret përgjatë gjashtë rrugëve automobilistike kryesore në qendrën e qytetit këtë vjeshtë morën pamje të re. Trotuaret e dëmtuara të cilat vite me radhë krijonin probleme në lëvizjen e këmbësorëve u gërmuan plotësisht dhe u shtruan me pllaka betoni parafabrikat, kurse për realizimin e këtij projekti voluminoz Qyteti i Shkupit ndau rreth 32 milion denarë.

Në rindërtimin e trotuarit në të dy anët e bulevardit "Goce Delçev", nga ura „Goce Delçev“ deri te kryqëzimi me rrugën "Vasil Axhillarski" punuan ekipet e IGM „Vratnica“. Korsia për këmbësorë në bulevardin

"Partizanski odredi", para Kishës së madhe, në një pjesë të bulevardit VMRO, si dhe korsia para objektit të BPU „Sv. Kliment Ohridski“ u rinovua nga ndërtimtarët e „Çingar Inzhiniering“. Në trotuarin përgjatë rrugëve "Vasil Axhillarski" dhe "11 Oktomvri", tek parku "Zhena borec" punuan ekipet e „Pelagonija – Gostivar“. Për rikonstrukcionin e zonës për këmbësorë në rrugën "Vasil Glavinov" dhe në një pjesë të bulevardit "Ilinden" (nga ura „Goce Delçev“ deri në ndërtesën e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë) u ngarkua kompania „Urban invest“.



Bulevardi „Goce Delçev“



Bulevardi „Ilinden“



Bulevardi „Partizanski odredi“



Rruga „11 Oktomvri“



Rruga „Vasil Glavinov“



Bulevardi VMRO

PAMJE E RE E URAVE



URA „GOCE DELÇEV“

Rrethim i ri mbrojtës dhe ndriçim i ri në tetor të vitit 2011 u vendos në urën „Goce Delçev“. Rrethimi i ri është ndërtuar prej profileve të tubave dhe përbëhet nga 148 elementë montues me gjatësi 3,6 metra dhe lartësi 1,2 metra, të cilat janë lidhur me shtylla.

Rikonstruksionin e rrethimit mbrojtës

të urës „Goce Delçev“ e realizuan ekipet e firmës ndërtimore „Bauer BG“, kurse në këtë projekt Qyteti i Shkupit investoi rreth 30 milion denarë.

Në urën „Goce Delçev“ është vendosur ndriçim i ri me 26 kandelabra, kurse në shtyllat 10 metra të larta deri te rrethimet e brendshme të urës janë vendosur llamba

të reja më moderne, në konzula dekorative. Në urë janë vendosur edhe llamba neoni për ndriçimin e trupit të urës, si dhe 76 reflektorë për ndriçimin ambiantal të kontureve të urës.

Për ndriçimin e rrugës „Goce Delçev“ u kujdesën ekipet e „Elektra-komerc“ Shkup, kurse për realizimin e kësaj pjese të projektit Qyteti i Shkupit ndau 3,7 milion denarë.



„URA E REVOLUCIONIT“

Edhe „Ura e Revolucionit“ u gdhi me pamje të re. Në urën që lidh bulevardet „Koço Racin“ dhe „Krste Misirkov“ janë rinovuar trotuaret, rrethimi mbrojtës dhe ndriçimi rrugor. Janë riparuar edhe pjesët prej betoni të dëmtuara në anën e jashtme të urës.

Ura e re është përgatitur nga hekur i farkëtuar. Në të janë montuar 22 kandelabra

dekorativ. Ura ndriçohet në mënyrë plotësuese nga 10 shtylla për ndriçim rrugor, kurse konturet e urës i thekson ndriçimi në linjë.

Rikonstruksionin e „Ura e Revolucionit“ e realizuan ekipet e kompanisë së ndërtimit „SINTEK DOO“ nga Shkupi. Për rinovimin e urës Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 27,6 milion denarë.



NË LUMIN VARDAR



URË E RE NË SARAJ

Në lumin Vardar në Saraj në vijim është ndërtimi i urës së re e cila do të jetë me gjatësi 50 metra. Kalimi i ri nëpërmjet Vardarit do të jetë prej betoni të armuar në tre harqe. Në urë do të ndërtohet rrugë automobilistike me nga dy korsi rrugore, korsi për biçikleta dhe këmbësorë. Rrethimi mbrojtës do të përbëhet nga shtylla çeliku të lidhura me llamarinë të

profiluar. Ura do të ndriçohet nga kandelabra çeliku.

Kalimin e ri mbi lumin Vardar e ndërtojnë ekipet e kompanisë së ndërtimit „Granit AD” – Shkup. Vlera e këtij projekti kapital është rreth 96,8 milion denarë, mjetet janë siguruar nga Qyteti i Shkupit, komuna e Sarajit dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë.





NDRIÇIM I RI NË ÇARSHI

Ndriçimi rrugor në Çarshinë e vjetër të Shkupit së shpejti do të rinovohet plotësisht. Me projektin për rikonstruksion do të përfshihen rrugët "Bitpazarska", "Drvarska", "Çarshia e mbuluar", "Gradishte", "Lazar Tanev", "Podragje", "Jorganxhiska", "Makarija Frçkovski", "Kazanxhiska", 694, "Qurçiska", "Evlija Çelebia", 412, "Papuxhiska", "Petar Mihov", "Teodosij Gologanov", "Kovačka" dhe "Samarxhiska".



RINOVHEN FASADAT NË QENDRËN E QYTETIT

Objekti mbi restorantin „Pelister“ në rrugën „11. Oktomvri“ numër 2 dhe ndërtesa në rrugën „Marshall Tito“ numër 22, së shpejti do të bëhen me fasadë të re. Ekipet e Qytetit të Shkupit këto ditë punuan edhe në rikonstruksionin e fasadës në një pjesë të objektit në rrugën „11 Oktomvri“ numër 2, hyrje 1, 2, 3, 4 dhe 5, që përbën vazhdim të objektit mbi restorantin „Pelister“ drejt sheshit „Pela“.



U RREGULLUA HAPËSIRA PËRRETH KRYQIT TË MILENIUMIT

Sheshi para Kryqit të mileniumit vitin e kaluar u rregullua plotësisht. Rreth Kryqit të mileniumit janë formuar dy pjesë rrethore, kurse sipërfaqja është shtruar me tipa të ndryshëm gurësh që i përshtaten ambientit malor. Në rrethet e sheshit janë vendosur pajisje urbane – stola, kosha për mbeturina dhe ndriçim. Për rregullimin e hapësirës Qyteti i Shkupit ndau rreth 4,7 milion denarë.



U RINOVUA SHESHI PARA KISHËS „SHËN. SPAS“

Qyteti i Shkupit rinovoi sheshin para kishës „Shën. Spas“. Pllakat e vjetra dhe të thyera u zëvendësuan me gurë kubik, kurse sheshi mori një pamje autentike.

Për rregullimin e hapësirës me sipërfaqe 270 metra katror Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth një milion denarë.



PAMJE E RE E QENDRËS KULTURORE RINORE ...

Objekti i Qendrës kulturore rinore në fillim të vitit mori një pamje të re. Me mjetet e marra nga Programi IPA i Bashkimit Evropian, në vlerë prej 35.000.000 denarë, ka përfunduar rikonstruksioni i çatisë së objektit, rikonstruksioni i fasadës së jashtme me zëvendësimin e dritareve ekzistuese dhe dyerve të jashtme, si dhe rikonstruksioni i nyjave sanitare dhe tualeteve. Qyteti i Shkupit si investitor i përbashkët në rikonstruksion siguroi mjete për furnizimin me pajisje audio dhe ndriçuese në vlerë prej 8 320 000 denarë.

Me mjetet e Qytetit të Shkupit në vlerë prej 7.250.000 denarë përfundoi riparimi i sallës së koncerteve dhe kinemasë „Frosina“ në QKR.



... DHE PËR SALLONIN 19:19

Salloni 19:19 në Qendrën kulturore informative i cili u rinovua në gjashtë muajt e kaluar hapi dyert për artistët dhe për publikun.

Me investimin e Qytetit të Shkupit prej 3,5 milion denarë është kryer riparimi i çatisë, ambienteve të grimit, tualeteve, gardërobave dhe hapësirave ndihmëse, dhe është rinovuar edhe salla hyrëse në Sallon. Donacioni prej 7 milion denarësh nga Fondacioni IMAC nga SHBA është shfrytëzuar për rinovimin dhe rregullimin e enterierit të sallës, ku janë montuar karrige të reja, konstrukcion tërësisht i ri skenik, është përmirësuar guaska akustike e Sallonit, është vendosur ndriçim i ri dhe aklimatizim qendror i hapësirës.



U RINOVUA OBJEKTI QKF „KARPOSH“

Plotësisht është rinovuar godina e Qendrës kulturore për fëmijë „Karposh“, në bulevardin „Ilinden“. Brendësia e shtëpisë është rinovuar dhe pajisur me mobilie të reja, kurse fasada e objektit është restauruar me ngjyrën e saj autentike. Në rinovimin e Qendrës Qyteti i Shkupit investoi rreth 6 milion denarë.



SHTËPIA E QYTETIT NË BREGUN E LUMIT VARDAR

Objekt i ri administrativ-afarist për nevojat e administratës së Qytetit të Shkupit do të ndërtohet në rrugën „Llazar Liçenovski“ nën Kalanë e Shkupit. Ndërtesa do të ketë kat përdhes dhe pesë kate dhe hapësirë për 650 të punësuar.

U RRI TËN KAPACITETET PËR PARKIM

NËN QENDRËN TRANSPORTUESE

Nën qendrën transportuese është hapur parking për automjete motorike të lehta me sipërfaqe 6 840 metër katror dhe me 218 vende të shënuara për parkim.

Qyteti i Shkupit vitin e kaluar përfundoi ndërtimin e parkingut për autobusë, fugon dhe për automjete të lehta motorike nën Qendrën transportuese. Parkingu i ri siguron 64 vende për parkim, dhe atë 10 vende për autobusë, 12 për automjete-fugon dhe 42 vende për automobila. Në këtë projekt Qyteti investoi rreth 11,6 milion denarë.



PARA KOPSHTIT ZOOLOGJIK

Nga ana e djathtë e bulevardit "Ilinden", para objektit të Kopshtit zoologjik, ekipet e Qytetit të Shkupit ndërtuan parkingun për 93 automjete. Parkingu u bë me ndriçim të ri, dhe është rrethuar me brez të gjelbër prej 10 metrash.

Në ndërtimin e parkingut të ri punuan ekipet e kompanisë së ndërtimit „Zhikol“, kurse Qyteti i Shkupit për këtë projekt ndau rreth 10 milion denarë.



TEK SALLA „JANE SANDANSKI“

Parkingu i bulevardit „AVNOJ“ përballë sallës sportive „Jane Sandanski“ në Aerodrom së shpejti do të ketë 120 vende parkimi plotësuese. Ky parking do të zgjerohet në gjatësi prej 300 metra, deri te stacioni i fundit i autobusit me numër 5.




NË RRUGËN „VASKO KARANGELEVSKI“

Në rrugën „Vasko Karangelevski“, në lagjen Aerodrom, është hapur parking për 220 automjete. Parkingu shtrihet në sipërfaqe prej 2 415 metra katror, kurse për ndërtimin e tij Qyteti i Shkupit ndau 5 milion denarë.



GARAZH ME KATE NË RRUGËN "MITO HAXHIVASILEV JASMIN"...

Garazhi me kate që ndërtohet në rrugën "Mito Haxhivasilev Jasmin" do të ketë dy kate nën tokë dhe shtatë kate mbi tokë, me 445 vende parkimi nga të cilat 17 vende për parkim do të jenë për persona me nevoja të veçanta. Për ndërtimin e garazhit me kate Qyteti i Shkupit do të shpenzojë rreth 656 milion denarë.



... DHE NË RRUGËN "DAME GRUEV"

Gjashtëqind e pesë vende të reja parkimi do të sigurojë garazhi me kate që do të ndërtohet në rrugën "Dame Gruev". Objekti i ri do të ketë shtatë kate mbi tokë dhe dy nivele nën tokë.

Objektin do ta ndërtojnë ekipet e kompanisë ndërtimit „Konstruktor inzhenering DD Split“, dhe pritet të jetë gati për dy vjet. Në këtë projekt kapital Qyteti i Shkupit do të investojë rreth 850 milion denarë.

PARA RTVM

Parking i ri nga viti 2010 funksionon edhe para ndërtesës së Radio televizionit maqedonas, ku është vendosur parkimi zonal. Parkingu është me kapacitet prej 130 automjete në sipërfaqe prej 2 800 metra katror.

Qyteti i Shkupit për rregullimin e këtij parkingu ndau rreth 3,5 milion denarë.



PRAPA QT „MAVROVKA“

Parkim zonal është vendosur në parkingun me 110 vende, prapa qendrës tregtare „Mavrovka“.

Sistemi i ri i parkimit u ndihmon qytetarëve të vijnë më lehtë deri te vendi i parkimit dhe zvogëlon kaosin në komunikacionin rrugor që krijohet në këtë vend me frekuencë të madhe.



PËRMIRËSIM I RRJETIT TË

Në bulevardin "Hristian Todorovski Karposh" në lagjen Butel u ndërtua kanalizim i ri atmosferik me gjatësi 547 metra. Rrjeti zgjidh në mënyrë të përherëshme problemet me përcjelljen e ujërave nga reshjet dhe përmbytjet e rrugës nga shirat e rërmyeshëm.



Stacioni i ri i pompimit për pranimin e ujërave të zeza në bregun e djathtë të lumit Vardar u promovua më 11 prill të këtij viti. Ndërtimi i stacionit është investim i përbashkët i Qytetit të Shkupit, komunës Aerodrom dhe Ministrisë së transportit dhe lidhjeve. Në vlerën e përgjithshme të këtij projekti prej 48 milion denarë Qyteti i Shkupit merr pjesë me 21 milion denarë.

Stacioni i ripompimit do të ripompojë në mënyrë direkte të gjitha ujërat e zeza të lagjeve Gorno Lisiçe, Aerodrom dhe të lagjes 11 Tetori në komunën Kisela Voda.



Është lëshuar në përdorim kanalizimi atmosferik në bulevardin "Serbia" tek fabrika e çimentos "Usje".

Me projektin e përbashkët Qyteti i Shkupit, komuna e Gazi Babës dhe Ministria e transportit dhe lidhjeve ndërtuan kanalizimin atmosferik dhe fekal në rrugën "Juzhnomoravski brigadi". Projekti është me vlerë prej 23 milion denarë.



Është ndërtuar plotësisht kolektori që mbledh ujërat atmosferik nga lagja Qeramidnica, si dhe ujërat nga kryqëzimi tek hoteli „Kontinental“ deri te derdhja në lumin Vardar, me gjatësi 530 metra. Për këtë projekt Qyteti i Shkupit ndau 26 milion denarë.

Qyteti i Shkupit në fund të vitit 2011 filloi ndërtimin e degës 2 të kanalizimit atmosferik në bashkësinë vendore „Bajram Shabani“, në komunën e Çairit. Gjatë punëve ndërtimore në gjatësi prej 810 metra do të vendosen tuba polietileni me diametër nga 300 deri në 800 milimetra, me puseta revizioni dhe vend derdhje. Dega 2 e kanalizimit të ri atmosferik do të lidhet me kolektorin ekzistues Ø 1900 mm në rrugën "Cvetan Dimov".

Për ndërtimin e degës 2 të këtij kanalizimi atmosferik Qyteti i Shkupit do të ndajë rreth 8,4 milion denarë pa TVSH, kurse në terren do të punojnë ndërtimtarët e „Pelagonija – Gostivar“.



UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT

Ndërtimi i fazës së tretë të rrjetit të kanalizimit fekal në fshatin Lubanci, e cila filloi më 15 mars, zhvillohet sipas dinamikës së parashikuar. Me këtë punë ndërtimore fshati Lubanci do të përfshihet në mënyrë të plotë në kanalizimin fekal.

Me punën ndërtimore do të ndërtohen tri degë të kanalizimit fekal në fshatin Lubanci, me gjatësi të përgjithshme 857 metra. Ky projekt është rezultat i bashkëpunimit të mirë ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe komunës së Butelit. Në projektin me vlerë 6,3 milion denarë Qyteti i Shkupit merr pjesë me 5 milion denarë.



Rrjeti i ri i ujësjellësit në rrugën "Pero Nakov", në komunën Gazi Baba përmirësoi furnizimin me ujë të pijshëm të 30 000 banorëve të lagjeve Maxhari, Hipodrom, Çento dhe zonën lindore industriale.

Kolektori fekal dhe atmosferik për lagjet Stajkovci, Çento, Inxhikovë, Hipodrom dhe Maxhari, si dhe stacioni i ripompimit për ujërat fekale „Makoshped“ në fund të vitit 2009 u ndërtua plotësisht dhe u lëshuan në përdorim.

Sistemi i kolektorit zgjidh problemet shumëvjeçare të rreth 30 000 banorëve. Ndërtimi i sistemit të kolektorit dhe rikonstruksioni i stacionit të ripompimit kush-tojnë 120 milion denarë, nga të cilat 61 milion denarë siguroi Qeveria e Republikës së Maqedonisë, kurse mjetet e tjera i siguroi NP „Ujësjellës dhe kanalizim“.



Ekipet e Qytetit të Shkupit ndërtuan plotësisht kanalizimin e ri fekal në bulevardin e ri të projektuar "ASNOM" në Gorno Lisiçe, në gjatësi prej 1 200 metra. Për këtë projekt u ndanë 18 milion denarë, para nga Buxheti i Qytetit të Shkupit.



Është rinovuar rrjeti i ujësjellësit në rrugën "Demir Trajko".

NDËRMARRJA PUBLIKE „DRISLA“



Me vendimin e Këshillit të Qytetit të Shkupit në fund të vitit 2009 u formua Ndërmarrja publike për deponimin e mbeturinave komunale „Drisla“ – Shkup, me të cilën depoja „Drisla“ u nda nga NP „Higjiena komunale“ si subjekt juridik i veçantë.

Arsyeja për formimin e ndërmarrjes publike të veçantë është nevoja e deponimit dhe përpunimit të mbeturinave sipas standardeve evropiane dhe botërore, gjë me të cilën Shkupi do të ketë depo sanitare.

Qyteti i Shkupit dhe NP „Drisla“ blenë shtatë automjete të përdorura që përmirësuan në mënyrë të ndjeshme punën në këtë ndërmarrje publike. Janë blerë 2 buldozerë, kompaktor për punën e depos, ekskavator, 2 kamionë dhe cisternë për ujë.

Vlera e përgjithshme e pajisjeve është rreth 40 milion denarë. Në periudhën e kaluar Qyteti i Shkupit investoi edhe 20 milion denarë në mënyrë plotësuese për ndërtimin e rrugës në depo, sistem për kapjen e burimit të ujit deri në Mavrova reka dhe ndërtimin e sistemit për ujëra të zeza.





1 300 kontejnerë të rinj dhe 4 500 kazanë me kapacitet 120 litra janë vendosur në shumë lokacione nëpër qytet, si donacion për Qytetin e Shkupit nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Ekipet e Qytetit të Shkupit dhe të ndërmarrjes publike „Rrugë dhe rrugica” ndërtojnë vende të reja për vendosjen e kontejnerëve në rrugët e qytetit. Qyteti i Shkupit do të ndërtojë 121 vende për vendosjen e kontejnerëve me kapacitet 1,1 metër kub.



Si pjesë e përpjekjeve të Qytetit të Shkupit për qytet më të pastër dhe ngritjen më efektive të mbeturinave të grumbulluara, amvisërive individuale në Shkup do t'u ndahen falas 60 000 kazanë plastik për mbeturina.

Vlera e këtij projekti është rreth 900 mijë euro, para të siguruar me kredi nga Banka botërore, me ndihmën e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Qyteti i Shkupit vendosi 116 kontejnerë të rrytëzuar me tre dhoma për mbledhjen e seleksionuar të plastikës, letrave dhe kanoçeve. Këto kontejnerë janë shpërndarë në të dhjetë komunat e Shkupit, gjë me të cilën u krijuan kushte që qytetarët e Shkupit mbeturinat nga paketimet nga amvisëritë e tyre t'i vendosin në kontejnerë adekuat të vendosur në lokacionin më të afërt.



NDËRMARRJA PUBLIKE „HIGJIENA KOMUNALE“



Ndërmarrja publike „Higjiena komunale“ nga fundi i vitit 2009 u pajis me gjashtë automjete të specializuara për grumbullimin e mbeturinave. Kamionët e rinj janë me vëllim 16 metra kub, me mekanizëm për ngritjen dhe zbrazjen e kontejnerëve standardë me vëllim 1,1 metër kub dhe kazanë me vëllim 120 dhe 240 litra.

Në furnizimin me automjete të reja Qyteti i Shkupit mori pjesë me rreth 16 milion denarë.

Në vitin 2010 Qyteti i Shkupit bleu gjashtë automjete të specializuara për grumbullimin e automjeteve të cilët rritën efikasitetin e NP „Higjiena komunale“. Kamionët e rinj janë me vëllim 20 metra kub, me sistem për ngritjen dhe zbrazjen e kontejnerëve me kapacitet 1,1 metra kub, dhe kazanë për mbeturina me vëllim 120 litra.

Çmimi i gjashtë automjeteve është rreth 50 milion denarë.



Është dyfishuar kapaciteti i stacionarit „Vardarishte“. Objekti është ndërtuar sipas standardeve evropiane dhe në të janë rregulluar 48 bokse të reja për akomodimin dhe trajtimin human të qenve endacakë.

Për zgjerimin e stacionarit „Vardarishte“ Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 7 milion denarë.



Grumbullohen rregullisht mbeturinat në ambientet rurale me dy automjete që i bleu komuna Kisela Voda dhe ia dhuroi NP „Higjiena komunale“. Kamionët mbledhin mbeturinat në lagjet Draçevë, Pintija, Usje dhe Pripor, ku kamionët e mëdhenj lëvizin me vështirësi.

Grumbulluesit joformal të mbeturinave të seleksionuara nënshkruan kontrata dhe u bënë pjesë e sistemit të integruar të NP „Higjiena komunale“ për seleksionimin dhe përpunimin e mbeturinave nga paketimi, që u jep njohje juridike për aktivitet e tyre. Nëntëmbëdhjetë grumbullues joformal grumbullojnë mbeturinat nga territori i komunës Gjorçe Petrov, Karposh dhe Qendër.

Mbeturinat e grumbulluara në oborrin e riciklimit në bulevardin „Ilinden“ i blen NP „Higjiena komunale“, e cila i merr, paketon dhe siguron plasman si lëndë dytësore nëpërmjet „Pakomak“.



Për nevojat e NP „Higjiena komunale“ Qyteti i Shkupit në korrik të vitit 2011 bleu rimorkio për transportin e gjedhëve. Rimorkioja do të shfrytëzohet për transportin e kuajve të cilët do të kapen në sipërfaqet publike të gjelbra nëpër qytet.

Për blerjen e rimorkios Qyteti i Shkupit ndau nga Buxheti 298.965 denarë.



Ndërmarrje publike „Higjiena komunale“ në vitin 2011 u pajis me 23 automjete të reja të specializuara për grumbullimin e mbeturinave. Për blerjen e gjashtë automjeteve të para të specializuara Qyteti i Shkupit i ndau NP „Higjiena komunale“ mjete të destinuara me vlerë prej 30,5 milion denarë. Për blerjen e 17 automjeteve për nevojat e ndërmarrjes mjetet në vlerë prej 110 milion denarë janë siguruar me kredi nga Republika e Maqedonisë nga Banka botërore në suazat e „Projekt për përmirësimin e shërbimeve komunale“, si nënhua e Qytetit të Shkupit.



Ndërmarrja publike „Higjiena komunale“ këtë vit u rinovua me dy automjete të specializuara për pastrimin e rrugëve automobilistike – fshesa dhe 5 kamion të vegjël për grumbullimin e mbeturinave. Për blerjen e automjeteve nga Buxheti i Qytetit u ndanë rreth 18 milion denarë.

Kamionët e vegjël për grumbullimin e mbeturinave nga rrugët e ngushta, pikërisht nga lagjet ku kamionët e mëdhenj nuk kanë qasje për shkak të konfiguracionit të terrenit, janë me kapacitet prej 5 metra kub, me sistem për ngritjen dhe zbrazen e kontejnerëve ose në të njëjtën kohë për ngritjen dhe zbrazen e 2 kazanëve për mbeturina me vëllim 120 litra.

Pesë kamion të vegjël për grumbullimin e mbeturinave ndërmarrja publike „Higjiena komunale“ i bleu me mjetet e veta.



Defektet e rrjetit të ujësjellësit në qytet i zbulon automjet special i NP „Ujësjiellës dhe kanalizim“ i cili kontribuoi për zvogëlimin e humbjeve të ujit në sistem. Automjeti është pajisur me të gjitha standardet më bashkëkohore dhe është i vetmi i këtij tipi në regjion.

Për blerjen e automjetit vitin e kaluar NP „Ujësjiellës dhe kanalizim“ ndau 7,5 milion denarë.

NDËRMARRJA PUBLIKE „UJËSJELLËS DHE KANALIZIM“



Ekipet e NP „Ujësjiellës dhe kanalizim“ në vitin 2009 filloi të vendosë tip të ri ujëmatësish me lexim në largësi në amvisëritë në Shkup.

Ky projekt i Qytetit të Shkupit dhe NP „Ujësjiellës dhe kanalizim“ lehtëson leximin e ujëmatësve, zvogëlon kohën e leximit dhe lajmëron për defektet e rrjetit në shtëpitë e qytetarëve për të penguar rrjedhjen e panevojshme të ujit.

NDËRMARRJA PUBLIKE „RRUGË DHE RRUGICA“

NP „Rrugë dhe rrugica“ mori makinë të re për shënimin e sinjalizimit horizontal në rrugët e qytetit me kapacitet më të madh dhe me rezervuar për bojë 150 litra.

Automjeti do të rrisë kapacitetin e shënimit dhe do të shkurtojë kohën e punës. Me këtë garantohej ndërprerje më e vogël e komunikacionit në periudhën e freskimit të sinjalizimit horizontal në rrugë.



Baza e asfaltit e NP „Rrugë dhe rrugica“ që gjendet në oborrin e fabrikës „Hekurana“ në Butel në vitin 2011 u rinovua sipas standardeve evropiane. Baza e asfaltit është tërësisht e automatizuar, prodhimi është i kontrolluar nëpërmjet sistemit kompjuterik, dhe është zgjidhur edhe problemi me ndotjen e ajrit nëpërmjet filtreve të reja të ajrit.

Me rikonstruksionin e bazës ndërmarrja publike përmirësoi efikasitetin në punë, u përmirësua kualiteti i asfaltit dhe koha e përgatitjes së tij, dhe u zvogëlua mundësia për defekte të mundshme.

Për rikonstruksionin e plotë të bazës Qyteti i Shkupit investoi 15 milion denarë.

NQP „SHKUP“



Gjatë vitit 2011 nëpër rrugët e qytetit filluan të qarkullojnë gjithsej 148 autobusë të rinj, dhe atë 68 autobusë dykatësh nga Kina dhe 80 me dyshe me ulët nga Ukraina. Muajin e kaluar arritën edhe 68 autobusë të rinj dykatësh. Me numrin e përgjithshëm prej 216 autobusësh të rinj për nevojat e NQP „Shkup“ është rinovuar 70% e parkut të automjeteve në këtë ndërmarrje publike.

Autobusët e rinj janë përgatitur sipas të gjitha teknologjive moderne dhe janë pajisur me informatorë të brendshëm dhe të jashtëm, kondicionerë, rampa për personat me nevoja të veçanta, si

dhe me motorë ekologjikë të cilët do të sigurojnë ndotje më të vogël të ajrit dhe do të shpenzojnë më pak karburant. Me blerjen e këtyre autobusëve ngadalë, por me siguri, zgjidhen problemet shumëvjeçare në transportin publik. Rinovimi i parkut të automjeteve të NQP „Shkup“ është rezultat i bashkëpunimit të mirë të Qytetit të Shkupit me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë.

Me projektin përrinovimin e parkut të NQP „Shkup“ është parashikuar blerja e 202 autobusëve dykatësh, 15 autobusëve dykatësh panoramik, si dhe 80 autobusëve me dyshe me ulët dhe 16 minibusëve.

Personat e moshuar kanë mundësi të udhëtojnë falas në autobusët e NQP-së të martën dhe të premten. Mundësia për transport falas ka të bëjë me qytetarët më të moshuar, më saktë për burra që kanë mbushur 64 vjet dhe gra që kanë mbushur 62 vjet.

Linja e autobusit me numër 3 është zgjatur deri te stacioni i ri autobusit tek hoteli i mëparshëm „Panorama“, në Vodno. Me zgjatjen e linjës së autobusit numër 3 iu përgjigjet kërkesave të 15 000 qytetarëve që jetojnë në këtë pjesë të Shkupit.

Pesëqind mijë qytetarë deri tani kanë hipur deri te Kryqi i mileniumit me teleferikun e ri. Traseja e këtij atraksioni të ri të qytetit është e gjatë 1 750 metra dhe ngjitet nga 570 metra lartësi mbi nivelin e detit në Vodno e mesme deri në 1 068 metra lartësi mbi nivelin e detit në Kryqin e mileniumit. Teleferiku disponon me 28 kabina për tetë persona dhe dy VIP kabina për katër persona. Gondolat e anës jashtme janë pajisur me mbajtës për biçikleta.

Teleferikun në Vodno e ndërtoi firma austriake „Doppelmaier“, kurse me të menaxhon Ndërmarrja e qarkullimit publik „Shkup“.





Salla e Ndërmarrjes së qarkullimit publik „Shkup“ në Gjorçe Petrov muajin e kaluar u rinovua dhe u riadaptua në një qendër shërbimi moderne për autobusët.

- Kjo sallë është rinovuar në qendër moderne shërbimi me kapacitet që të shërbejë në të njëjtën kohë më së paku 5 njësi ose 3 autobusë fizarmonikë, kurse që të kenë mundësi të servisohen autobusët dykatësh është rritur lartësia. Në muajt që vijojnë duhet të rinovohet edhe salla e dytë e cila do të pajiset me lavazh modern, kurse për realizimin e këtij projekti Qyteti i Shkupit nga Buxheti ndau 15 milion denarë – tha kryetari Koce Trajanovski, në promocionin e qendrës së servisit.

Ky është investimi i parë në sallën e NQP-së nga viti 1995.

Ndërmarrja e qarkullimit publik „Shkup“ lidhi kontratë për partneritet publik-privat me kompaninë greke „Remedi advertaizing“ për përgatitjen e 275 stacioneve të autobusit nëpër trasenë e autobusëve të transportit publik urban. Sipas kontratës, duhet të përgatiten:

- 65 stacione autobusi me strehë, stola, kosha për mbeturina, pano reklamuese, llamba, tabelë informuese me numrin e autobusëve që qëndrojnë në stacion;

- 117 stacione autobusi me strehë, kosha për mbeturina, pano reklamuese, llamba, tabelë informuese me numrin e autobusëve që qëndrojnë në stacion;

- 93 stacione autobusi (dyshe) me strehë, stola, kosha për mbeturina, pano reklamuese, llamba, tabelë informuese me numrin e autobusëve që qëndrojnë në stacion.



Firma „Remedi advertaizing“, sipas kontratës, duhet të përgatisë edhe 80 ekrane informative elektronike, dhe do t'i japë me qira vetëm sipërfaqet reklamuese të stacioneve të autobusëve.

BRIGADA PËR MBROJTJEN KUNDËR ZJARRIT



Parku i automjeteve të Brigadës për mbrojtjen kundër zjarrit të Qytetit të Shkupit vitin e kaluar u pasurua edhe me tre automjete të reja zjarrfikëse për shuarjen e zjarreve në hapësira urbane. Një automjet zjarrfikës është blerë nga Qyteti i Shkupit, kurse dy automjete zjarrfikëse janë donacion nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

- Për këtë profesion janë të nevojshëm njerëz të sakrificave të cilët rrezikojnë jetën e tyre për të shpëtuar jetën e të tjerëve të cilët janë në rrezik. Shfrytëzoj këtë mundësi që në emrin e qytetarëve të Shkupit dhe në emrin tim personal t'ju shpreh mirënjohjen më të thellë. Përkrahja e Qytetit të Shkupit për Brigadën zjarrfikëse është shumë e madhe dhe ajo

do të vazhdojë edhe më tej. Në këtë drejtim, parku i automjeteve i Brigadës për mbrojtjen kundër zjarrit të Qytetit të Shkupit që nga dita e sotme është pasuruar me tre automjete të reja zjarrfikëse për shuarjen e zjarreve në ambiente urbane. Një automjet është blerë nga Qyteti i Shkupit, kurse dy automjete zjarrfikëse janë donacion nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Qyteti i Shkupit për blerjen e automjeteve zjarrfikëse ndau nga buxheti rreth 13.600.000 denarë. Tre automjetet e reja për shuarjen e zjarreve në ambiente urbane do të përmirësojnë në mënyrë të ndjeshme kapacitetet e Brigadës për mbrojtjen kundër zjarrit të Qytetit të Shkupit – tha kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski.



Gjatë vitit 2010, Qyteti i Shkupit për Brigadën për mbrojtjen kundër zjarrit bleu pajisje të reja speciale si vijon: dy varka shpëtimi me motor, termo kamera, dy automjete terreni, nënkapele mbrojtëse dhe doreza sipas standardeve evropiane dhe uniforma verore për zjarrfikësit.

Gjatë vitit 2010 është rinovuar një pjesë e nyjave sanitare në nëstacionin Autokomanda, është rinovuar një pjesë e nënqendrës zjarrfikëse „Taftalixhe“, është blerë material zyre, mobilie për përmirësimin e kushteve akomoduese, si dhe pajisje informatike për nevojat e Brigadës.

Qyteti i Shkupit në vitin 2010 investoi rreth 20 milion denarë për blerjen e pajisjeve për Brigadën për mbrojtjen kundër zjarrit të Qytetit të Shkupit.

Brigada për mbrojtjen kundër zjarrit mori edhe 3 automjete të reja zjarrfikëse të dhuruara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.





Brigada për mbrojtjen kundër zjarrit e Qytetit të Shkupit në vitin 2009 mori donacion pajisje zjarrfikëse të shfrytëzuara nga qyteti i vëllazëruar Nirenberg, RF Gjermane. Bëhet fjalë për 120 aparate për frymëmarrje Dreger PA 80 në presion normal, 100 maska për frymëmarrje të tipit AUER3S, 30 aparate për frymëmarrje Dreger PA 94, 450 bombola çeliku për presion 300 ber, 80 bombola kompozite nga 6,9 litra në 300 bar, 4 karroca për transportin e të njëjtave, 1 komplet për analizën e sërishme të kualitetit të ajrit, 300 aparate për paralajmërim nga ekzistenca e rrezikut për vdekje dhe pjesë rezervë për aparatet e frymëmarrjes me mjet special dhe libër udhëzimi.

Vlera e donacionit të qytetit të Nirenbergut është rreth 300 000 euro.



Vitet e kaluara, në lokacione të ndryshme nëpër qytet, janë vendosur 40 hidrantë mbitorësor për nevojat e brigadës për mbrojtjen kundër zjarrit. Hidrantët janë vendosur para SHF „Koço Racin“, në bulevardin „Ilinden“ përballë QKF „Karposh“, në bulevardin „Krste Misirkov“ tek Rektorati, në rrugën „Xhon Kenedi“ përballë postës, në lagjen Przhino afër kopshtit, në rrugën „Fevruarski pohod“ përballë pompës së benzinës, në rrugën „Nikolla Tesla“ numër 8, në rrugën „Gjorçe Petrov“ numër 33, në rrugën „Koçe Metalec“ në rrugën „Ferd Bajram“ dhe në lokacione të tjera nëpër qytet.



NDËRMARRJA PUBLIKE

„PARQE DHE GJELBËRIM“



Ndërmarrja publike „Parqe dhe gjelbërim“ në fund të vitit të kaluar u rinovua me tri makina shumëqëllimore, rajder për kositjen e barit, në të cilat mund të montohet mulçer, pjesë shtesë që përdoret për kositjen e barit nëpër të cilin ka shkurre ose bar të ashpër. Bëhet fjalë për makina shumë të fuqishme, pikërisht me një makinë për një ditë mund të kositet pjesa e parë e parkut.

Është blerë edhe kamion me platformë ngritëse për prerjen dhe krasitjen e drurëve në lartësi prej 13,5 metra dhe kamion me mekanizëm për ngarkim dhe shkarkim.

Qyteti i Shkupit për furnizimin me pajisje të reja për NP „Parqe dhe gjelbërim“, të cilat janë destinuar për përmirësimin e punës në këtë ndërmarrje publike në pjesën e mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra dhe drurëve në parqe dhe bulevarde, nga Buxheti ndau 7,5 milion denarë.



Qyteti i Shkupit për nevojat e NP „Parqe dhe gjelbërim“ vitin e kaluar bleu dy traktorë me rimorkio dhe makina lidhëse për kositjen e barit; 10 kositëse bari me kosh; 10 kositëse motorike manuale me kosh dhe 14 trimer gjë me të cilën do të përmirësohet efektiviteti i kualitetit të punës në këtë ndërmarrje publike.

Për furnizimin me pajisjet e reja Qyteti i Shkupit nga buxheti ndau 3,5 milion denarë.



Qyteti i Shkupit në vitin 2010 bleu dy automjete për NP „Parqe dhe gjelbërim“. Bëhet fjalë për një ekskavator dhe një automjet cisternë i cili shfrytëzohet për ujitjen e sipërfaqeve të gjelbra dhe të drurëve në bulevarde në afërsi të të cilëve nuk ka hidrante për ujitje, si dhe për larjen e korsive në parkun e qytetit. Sipas nevojës, ky automjet mund të shfrytëzohet edhe për shuarjen e zjarreve eventuale në park pyllin Vodno.

Për blerjen e automjetit Qyteti i Shkupit ndau 5,8 milion denarë.

Më parë, qyteti i Shkupit për NP „Parqe dhe gjelbërim“ bleu edhe hapës kanalesh dhe një automjet me platformë për krasitjen e degëve të larta.



KOMPOSTIMI I MBETURINAVE ORGANIKE

Gjethet e mbledhura nga sipërfaqet publike transportohen deri te kompostara në oborrin e NP „Parqe dhe gjelbërim“ ku deponohen për prodhimin e plehut organik – kompostos.

Plehu i prodhuar tashmë shfrytëzohet në prodhimin e fidanëve të luleve.

NË PARK PYLLIN „VODNO“

Dy vend panoramat në Vodno janë rinovuar plotësisht, kurse ambienti është pajisur me stola dhe kosha për mbeturina. Është rregulluar edhe rrethimi i ri.



Dy vend panoramat ndriçohen nga llamba të reja kursyese me energji diellore. Janë vendosur gjithsej 24 llamba, dhe atë 11 në vend panoramën 1 dhe 13 llamba në vend panoramën 2. Ndriçimi me llamba me energji diellore mundëson që të mos ketë shpenzime për energjinë elektrike. Me këtë projekt, Qyteti i Shkupit, vërteton edhe njëherë përpjekjet e tij për efikasitet energjetik dhe ruajtjen e ambientit jetësor.

Për ndriçimin e ri të vend panoramave Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 2 milion denarë.

Në vend panoramën e sipërme në vitin 2010 u vendos dylbi për shikimin panoramik të qytetit.





Vetëm vitin e kaluar në disa lokacione në park pyllin Vodno u ndërtuan 2 kompozita me vend panorama të përbëra nga tre elemente nën Kryqin e mileniumit, një terren për fëmijë, 4 shtëpiza druri, 4 vend panorama njëshe, 18 komplete tavolinash dhe stola dhe 55 kosha për mbeturina.

Në suazat e aktiviteteve të rregullta të Qytetit të Shkupit për mirëmbajtjen e gjelbërimit në park pyllin „Vodno“ tre vitet e kaluara janë pyllëzuar 29 hektarë me fidanë gjethe mbajtës dhe gjetherënës.



U RINOVUA RRUGA VODNO E MESME - MANASTIR „SHËN PANTELEJMON“

Nga fundi i vitit 2009 u rinovua rruga nga Vodno e mesme deri te manastiri „Shën. Pantelejmon“. Pjesët e dëmtuara të rrugës u gërryen dhe u asfaltuan, kurse u vendosën tuba prej betoni të armuar për përcjelljen e ujërave atmosferik.

Rikonstruksioni i rrugës Vodno e mesme – manastir „Shën. Pantelejmon“ i kushtoi Qytetit të Shkupit rreth katër million denarë.



NË PARK-PYLLIN „GAZI BABA“



Për të rritur sigurinë e kalimtarëve ekipet e Qytetit të Shkupit verën e kaluar vendosën llamba të reja në korsi në park-pylin „Gazi Baba“ në gjatësi prej 680 metra. Janë vendosur 29 shtylla të reja dekorative për ndriçim publik me lartësi 4,5 metra dhe llamba me fuqi 150 W.

Qyteti i Shkupit ndërtoi korsinë për këmbësorë të gjatë 720 metra dhe të gjerë 1,90 metra përgjatë kufirit të park-pyllit „Gazi Baba“, nga parkingu tek Shtëpia e shëndeti „Hekurana“ deri te tereni për fëmijë. Kjo korsi mban emrin „Korsia e miqësisë me natyrën“.

Korsia është asfaltuar. Për ndërtimin e saj Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth një milion denarë. Në park-pylin „Gazi Baba“ është rregulluar korsia për këmbësorë me gjatësi 3 kilometra.

Pesë elementë rekreativ u ndërtuan në park -pyllin „Gazi Baba“ në vitin 2009. Janë vendosur shtatë komplete tavolinash me stola, si dhe 15 kosha për mbeturina.

Në park-pylin „Gazi Baba“ në vitin 2010 Qyteti i Shkupit vendosi 3 vend panorama, shtëpi për alpinistë, 11 komplete tavolinash me stola dhe tre tabela informative në hyrjen në peizazhin karakteristik.

Në park -pyllin „Gazi Baba“ vitin e kaluar u vendosën 7 komplete tavolinash me stola dhe 46 kosha për mbeturina, dhe u rinovuan edhe pajisjet urbane ekzistuese.



Në suazat e aktiviteteve të rregullta për mirëmbajtjen e gjelbërimit ekipet e Qytetit të Shkupit në park-pylin „Gazi Baba“ pyllëzuan 1,5 hektarë me drurë gjetherënës.



NË KANIONIN MATKA

U PASURUAN ME PESHQ UJËRAT E LIQENIT MATKA

Qyteti i Shkupit ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi mbrojtjen dhe riprodhimin e troftës endemike maqedonase në ujërat e Maqedonisë. Në këtë drejtim u realizuan disa aksione për pasurimin me peshq të ujërave të liqenit Matka dhe lumit të Vardarit me troftën endemike *Salmo macedonicus*.



Korsia për këmbësorë në kanionin Matka, nga kisha „Shën Andrea“ deri te vendi i quajtur Visok rid është rinovuar në gjatësi 4 000 metra. Përgjatë korsiës është montuar rrethimi mbrojtës me gjatësi të përgjithshme 600 metra, i përgatitur nga profile çeliku. Është rinovuar edhe vetë korsia me gurë, kurse në disa vende janë bërë zgjerime për stola dhe për kosha për mbeturina.

Për rikonstruksionin e plotë të kësaj korsie për këmbësorë dhe rrethimit mbrojtës Qyteti i Shkupit nga Buxheti ndau rreth 4 milion denarë.



EKSPEDITA E ZHYTËSVE SPELEOLOGË NË SHPELËN VRELO

Ekspedita evropiane e zhytësve speleologë „Vrelo 2010“ e udhëhequr nga italianii Luixhi Kasati, arriti deri në thellësinë 212 metra në shpellën Vrelo në Matka. Kjo thellësi e arritur përbën rekordin e dytë për thellësi në Evropë, kurse të parin në Ballkan.

Qyteti i Shkupit si sponsor kryesor i ekspeditës, përkrah këtë projekt me një milion denarë.



U NDRIÇUA TRASEJA NGA FSHATI GLUMOVË DERI TE HIDROCENTRALIT „MATKA“

Për rritjen e shikimit të rrugës dhe për rritjen e sigurisë në komunikacionin rrugor, muajin e kaluar traseja nga fshati Glumovë deri në hyrjen e hidrocentralit „Matka“ u ndriçua plotësisht.

- Traseja në të cilën është ndërtuar ndriçimi rrugor është me gjatësi rreth 2 kilometra dhe në të janë vendosur 64 shtylla me lartësi nga 8 metra, kurse në çdo shtyllë ka llambë me fuqi 150 W. Ndriçimin të cilin e bëmë në këtë drejtim do të kontribuojë për rritjen e shikimit të rrugës, gjë me të cilën do të rritet siguria e banorëve të këtyre dy fshatrave, e pronarëve të vilave në rrethinën e Matkës, si dhe e turistëve që në orët e mbrëmjes vizitojnë kanionin Matka – theksoi kryetari Koce Trajanovski, në promocionin e ndriçimit të ri.

Realizues i punëve në terren ishte firma „ELTRA“ nga Shkupi, kurse vlera e përgjithshme e punëve të kryera është rreth 5 milion denarë.

PAMJE MODERNE E KOPSHTIT ZOOLOGJIK



Në vitin 2010, 2011 dhe 2012 në suazat e rikonstruksionit të Kopshtit zoologjik u ndërtuan dhe u lëshuan në përdorim 40-të vend banime për kafshët, ndërmjet të cilëve për luanë, rakun, krokodila, leopardë, kangurë, mjellma të zeza, papagall, shpendë grabitqar – volier, antilopa aksis, drerë, gibbonë, shpendë ekzotik, papagall Ara, bufa pylli dhe dimri, tetarium për zvarranikë me vendbanime për merkatë dhe vendbanim për majmunë.

Në kopshtin zoologjik janë ndërtuar edhe Qendra edukative, tualet me platformë– vend panoramë, sallë luajtjeje për fëmijë, rrethime mbrojtëse për vizitorët, tabela informative, edukative për kafshët, liqen me shatërvan dhe urë, është rregulluar edhe hyrja në Kopshtin zoologjik, kurse është vendosur edhe rrethim mbrojtës edukativ - pano me kafshë.





Janë rinovuar vendbanimet e arinjve, buajve, gjedhëve zebu dhe lamave, drerëve, deleve dhe dhive, struçëve, kuajve poni dhe drerëve fisnik.

Në fazën përfundimtare është ndërtimi i vendbanimit për elefantin dhe gjirafën. Vendbanimet e reja ndërtohen në një sipërfaqe prej rreth 4 000 metra katror, kurse vetë objektet shtrihen në një sipërfaqe prej 400 metrash katror.

Projekti do të kushtojë rreth 15 milion denarë, para që do të sigurohen tërësisht nga Buxheti i Qytetit të Shkupit.

Në vijim është ndërtimi i Kopshtit botanik.



Në Kopshtin zoologjik të Shkupit jetojnë 490 kafshë, të 93 llojeve të ndryshme.



PAMJE E RE E PARKUT TË QYTETIT



Qyteti i Shkupit për nevojat e qytetarëve të cilët ruajnë kanakarë shtëpiakë në pjesën e dytë të qytetit të Parkut të qytetit ndërtoi Park për kanakarë, me sipërfaqe 1. 200 metra katror, i cili është i pajisur me përmbajtje të ndryshme dhe rekuizita për zbatimje për kanakarët.

- Në brendësi të parkut ka çezmë nga e cila kanakarët do të mund të pinë ujë, janë vendosur stola për të pushuar pronarët e kanakarëve dhe tre kosha specializuar me qese të vogla dhe të mëdha për mbledhjen e jashtëqitjeve të qenve. Me realizimin e projektit Qyteti i Shkupit plotësoi nevojat e qytetarëve të cilët ruajnë kanakarë, por edhe kërkesat e qytetarëve që shëtisin fëmijët e tyre në Parkun e qytetit, sepse mendojmë se me ndërtimin e këtij parku do të përmirësohet higjiena e përgjithshme në sipërfaqet e gjelbra në Park. Kështu, nëse dikush nga

pronarët e kanakarëve e shëtit qenin në sipërfaqet e gjelbra në Park, ose në korsi pa maskë, pa zinxhir dhe nuk mban qese për mbledhjen e jashtëqitjes, mbajtësit e rendit komunal do të intervenojnë dhe do ta ndëshkojnë – tha kryetari Koce Trajanovski, në promocionin e Parkut për kanakarë.

Parku për kanakarë është ndërtuar me rrethim teli me lartësi 1,5 metra, të vendosur në tuba metalikë dhe ka dy hyrje.

Në ndërtimin e Parkut për kanakarë punuan ekipet e ndërmarrjeve publike „Parqe dhe gjelbërim“, „Rrugë dhe rrugica“ dhe „Ujësjellës dhe kanalizim“, kurse në këtë projekt janë investuar rreth 460 000 denarë.

Këtë projekt pilot Qyteti i Shkupit e realizoi në bashkëpunim me organizatat joqeveritare dhe shoqatat për mbrojtjen e kafshëve.



Liçeni në Parkun e qytetit mori pamje të re. Është betonuar fundi dhe pjerrësitë e liçenit me sipërfaqe rreth 3 000 metra katror, gjë me të cilën do të pengohet rrjedhja dhe do të përmirësohet kualiteti i ujit.

Për realizimin e këtij projekti Qyteti i Shkupit ndau 3,8 milion denarë.

Në pjesën e parë të Parkut të qytetit ekipet e Qytetit të Shkupit vitin e kaluar ndërtuan katër çezma të reja të stilizuara për ujë. Çezma e parë është në formë shtatëkëndëshi prej gize, e dyta është vendosur tek Guaska dhe rrjedh me ujëvarë, në një çezmë është vendosur stema e Qytetit të Shkupit, kurse çezma e ndërtuar tek terrenet e tenisit është përgatitur me elementë hekuri të farkëtuar.

Në këtë projekt Qyteti i Shkupit investoi 1,2 milion denarë.



Qyteti i Shkupit në pjesën e parë të Parkut të qytetit vendosi gjashtë instalime hapësinore edukative të vendosura në dy grupe tematike, „Në botën e fantazive të fëmijëve” të Ivana Topalovska dhe „Njeriu dhe ambienti i tij” i Risto Avramovski. Çdo instalim edukativ i rregulluar në dy katet e reja për fëmijë është përgatitur sipas tematikës së përrallave për fëmijë.

Në grupin e parë „Në botën e fantazive të fëmijëve” janë vendosur tre instalime „Alisa në botën e çudirave”, „Magjistari nga Oz” dhe „Pinokio”, kurse në grupin e dytë të titulluar si „Njeriu dhe hapësira e tij” instalimet hapësinore janë „Nesi”, „Totem” dhe „Ksilofon”.

Kontrata për përgatitjen dhe montimin e instalimeve hapësinore edukative në Parkun e qytetit në Shkup u nënshkrua ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe „ARHITEKTRI” SH.P.K – Shkup.



Për më të vegjlit, në pjesën e parë të Parkut të qytetit, ekipet e Qytetit të Shkupit ndërtuan dy kate fëmijësh me sipërfaqe nga 200 metra katror. Katet janë me ngjyra intensive dhe me përmbajtje të pasura dhe interesante, të destinuara për fëmijët deri në moshën 12 vjeç.

Qyteti për ndërtimin e terreneve për fëmijë shpenzoi 350 000 denarë.

Si pjesë e aktiviteteve pranverore për rregullimin e pajisjeve të parkut dhe elementeve ekipet e NP „Parqe dhe gjelbërim” ditët që kaluan lypen rreth 100 stola në pjesën e parë dhe të dytë të Parkut të qytetit, kurse në rreth 100 stola zëvendësuan vidat e vjetra me të reja. Një pjesë e stolave janë lypur me ngjyrë të kuqe dhe të zezë, kurse një

pjesë me ngjyrë të kuqe dhe të gjelbër.

Janë lypur edhe tualetet në pjesën e parë dhe të dytë të Parkut të qytetit. Me bojë të re janë freskuar edhe përmbajtjet për fëmijë dhe instalimet në Parkun e qytetit, si dhe rekuizitat për rekreacion për fëmijët në vetë hyrjen e „Luna park”.

AKSION I MADH PËR RINOVIMIN E GJELBËRIMIT

Tre vitet e fundit ekipet e Qytetit të Shkupit në sipërfaqet publike mbollën 42 000 drurë që kontribuan për gjelbërimin e Shkupit dhe për përmirësimin e kushteve në ambientin jetësor. Janë ndërtuar dhe është rregulluar hortikultura në sipërfaqet e parkut dhe zhardinierët e mesëm në rrugët e qytetit, dhe është vendosur rrjeti hidrant.



Qyteti i Shkupit vjeshtën e kaluar realizoi aksionin për rinovimin e drurëve përgjatë bulevardeve dhe në sipërfaqet e reja të parkut të ngritura. Në aksion u mbollën 2 100 fidanë gjetherënës dhe gjethembajtës, të 17 llojeve të ndryshme.

Në fazën e parë të këtij aktiviteti u rinovuan drurët në bulevardet "Sveti Klimet Ohridski" "Mitropolit Teodosij Gologanov", "Video Smilevski Bato", "Partizanski odredi" dhe "8 Shtetvri". Qershi japoneze janë mbjellur tek parkingu i Kopshtit zoologjik.

Qyteti i Shkupit për realizimin e mbjelljes në vjeshtë të 2 100 fidanëve ndau rreth 6 milion denarë. Ky aktivitet do të vazhdojë edhe vitin e ardhshëm.

U RREGULLUAN ZHARDINIERËT E MESËM

Ekipet e NP „Parqe dhe gjelbërim“ vitin e kaluar rregulluan hortikulturën në tre zhardinierët e bulevardit "Video Smilevski - Bato.

Gjelbërim i ri në zhardinierën e mesme në bulevardin "Partizanski odredi, në drejtimin nga ura „Obedineti naci“ deri te kryqëzimi tek Porta Villae.

Në vitin 2010 u rregullua me gjelbërim zhardiniera në bulevardin "Jane Sandanski" në drejtimin nga qendra tregtare „Biser“ deri te kryqëzimi me bulevardin "Serbia". Zhardiniera është e gjatë një kilometër.

Në katër aksione për ndarjen e fidanëve të gjithë qytetarëve të interesuar (këshillave banesor), bashkësive vendore dhe urbane, institucioneve shëndetësore, kulturore, arsimore dhe institucioneve publike në dy vitet e kaluara Qyteti i Shkupit u ndau 10 000 fidanë.





TREGU I LULEVE NË LOKACION TË RI

Tregu i luleve u transferua në lokacion të ri, përballë Shtëpisë botuese. Në një sipërfaqe prej 242 metra katror u ndërtuan 16 dyqane lulesh të rregulluara në dy reshta. Ekipet e Qytetit të Shkupit ndërtuan platformën në të cilën do të vendosen dyqanet. Ndërtimi i dyqaneve është financuar nga qiramarrësit, kurse mjetet e investuara do t'u zbriten nga qiramarrja që duhet të paguajnë për marrjen me qira të hapësirës që shfrytëzojnë.

„DITA E DRURIT“

Qyteti i Shkupit u përfshi në aksionin „Dita e drurit“ dhe organizoi aktivitete për pyllëzimin e park pyllit „Vodno“ dhe „Gazi Baba“, si dhe të shumë lokaliteteve rreth Shkupit. Në aksionin e fundit „Dita e drurit – vjeshtë 2011“ përfaqësuesit e Qytetit të Shkupit, në suazat e park pyllit „Vodno“, në katër lokacione mbollën 10 000 drurë dhe atë, 3 000 selvi dhe 7 000 pisha.



KONKURS PËR KONTRIBUTIN MË TË MADH PËR AMBIENTIN JETËSOR

Qyteti i Shkupit më 5 qershor – Ditën e ambientit jetësor zgjodhi më të mirët në konkursin tradicional për zgjedhjen e kompanisë më ekologjike, kontributin më të madh në fushën e ambientit jetësor, oborrit e rregulluar më mirë, për hartimin dhe vizatimin më të mirë me temë nga ekologjia, që organizohet në suazat e manifestimit tradicional „Ditë të pranverës-Ditë të ekologjisë“. Konkursi ka si qëllim promovimin dhe popullarizimin e ambientit jetësor në Shkup, si kusht të vetëm për jetë të shëndetshme.

INFO QENDËR PËR EFIKASITET ENERGJETIK

Në ambientet e qytetit të Qytetit të Shkupit u hap Zyra për menaxhimin me energjinë dhe Info-qendër për efikasitet energjetik dhe burime ripërtëritëse të energjisë.

Në Zyrën e qytetarëve të Shkupit mund të marrin informacione të zbatueshme si të zvogëlojnë shpenzimin e energjisë në shtëpitë e tyre.



PLANI I DYTË AKSIONAR EKOLOGJIK LOKAL (PAEL 2)

Qyteti i Shkupit promovon Planin e dytë aksionar ekologjik lokal për Shkupin (PAEL 2), dokument strategjik i cili vërteton ndryshimet në ambientin jetësor në qytet 5 vitet e fundit dhe propozon masa dhe aktivitete për mbrojtjen dhe avancimin e ambientit jetësor. Përgatitja e PAEL 2 del nga nevoja e qytetarëve për ambient jetësor të pastër dhe të shëndetshëm, por edhe si obligim i Qytetit të Shkupit në përputhje me Ligjin për ambientin jetësor.

Dokumenti përfshin pesë fusha tematike: mbeturina, ujë, ajër, truall dhe natyrë, konstaton ndryshimet në ambientin jetësor dhe nxit bashkësinë lokale të ndërmarrë hapa konkretë për ruajtjen dhe avancimin e ambientit jetësor. PAEL 2 e përgatitën persona profesionistë të „Euromak kontrol“, në bashkëpunim me Qytetin e Shkupit.

Qyteti i Shkupit realizon monitorimin hulumtues një vjetor për ujërat sipërfaqësor dhe nëntokësor në Luginën e Shkupit, ujërat që ushqejnë burimin e Rashçes dhe ujërat që ushqejnë territorin e puseve Nerezi-Lepenec. Në të gjitha rrjedhat e ujit janë vendosur vende matëse dhe janë ndërtuar piezometra për ndjekjen e ujërave nëntokësor. Monitorimin e ujërave e vazhdon NP „Ujësjellës dhe kanalizim“. Për këtë projekt voluminoz Qyteti i Shkupit ndau rreth 12.2 milion denarë.

Është realizuar hulumtimi i truallit të Luginës së Shkupit nga aspekti i ndotjes me metale të rënda.



JAVA EVROPIANE E MOBILITETIT

Vitin e kaluar Qyteti i Shkupit hyri në familjen e madhe të qyteteve evropiane të cilët çdo vit organizojnë fushatën gjerësisht të përhapur për mobilitet të qëndrueshëm— Java evropiane e mobilitetit në të cilën anëtarësohen dhe janë aktivë disa mijëra qytete evropiane nga Evropa me mbi 220 milion banorë.

Në qytet u mbajtën shumë aktivitete për promovimin e mobilitetit alternativ dhe ngritjen e vetëdijes ekologjike.



EKRAN PËR MATJEN E KUALITETIT TË AJRIT

Nga pranvera e kaluar kualitetin e ajrit në qendrën e qytetit e mat ekran special i vendosur në rrugën „Maqedonia“, para Shtëpisë së ARM-së. Ekranin tregon vlerat momentale të matura të materieve ndotëse në ajër në mënyrë grafike dhe jep rekomandime për shëndetin e qytetarëve.

Ekranin mat sasinë e monoksidit të karbonit, sulfur dyoksidit, oksideve të azotit dhe grimcave partikulare më të vogla se 10 mikrometra, gjithashtu maten dhe tregohen edhe parametrat meteorologjik – temperatura e ajrit, shpejtësia dhe drejtimi i lagështisë së ajrit.



AKSION PËR SHKUPIN E PASTËR DHE TË GJELBËR

Aksioni për pastrimin e sipërfaqeve të gjelbra në dhjetë komunat e Shkupit nën moton „Së bashku për Shkupin e pastër dhe të gjelbër“ u bë traditë. Aktivitetet realizohen dy herë në vit.

Në pastrimin e depove informate, kositjes së barit, rregullimit të

gjelbërimit, kontrollit të rrjetit të kanalizimit, pastrimit të vend derdhjeve dhe riparimit të gropave të mëdha në rrugë u përfshinë ndërmarrjet publike „Parqe dhe gjelbërim“, „Higjiena komunale“, „Ujësjellës dhe kanalizim“ dhe „Rrugë dhe rrugica“.



KOSHA PËR MBETURINA TË SELEKSIONUARA PËR FËMIJË

Kopshtet „Tashko Karaxha“ në komunën Butel, „Koço Racin“ në komunën Qendër, „Orce Nikollov“ në komunën Karposh, „8- Marsi“ në komunën Kisela Voda, „Dreri“ në komunën Aerodrom, „Gëzimi fëmijëror“ në komunën Gazi Baba, „Fidanë“ në komunën e Çairit, „Borëbardha“ në komunën Shuto Orizare, „Rosica“ në komunën Gjorge Petrov dhe shkolla „Liria“ në komunën e Sarajit morën nga një komplet koshash për mbeturina të seleksionuara. Koshat e rinj që i bleu Qyteti i Shkupit, janë në formën e kafshëve – ari, delfin dhe bretkosë dhe në ta mund të mblidhen letra, plastikë dhe kanoçe. Gjashtë komplete me nga tre kosha janë vendosur në Kopshtin zoologjik.

Koshat janë bërë nga material ekologjik dhe nga bojëra ekologjike. Fëmijët nëpërmjet lojës dhe zbatimit do të kenë mundësi të mësojnë të veprojnë në mënyrë të drejtë me mbeturinat, të seleksionojnë dhe ta ruajnë ambientin jetësor.

Për furnizimin me kosha Qyteti i Shkupit ndau rreth 1,8 milion denarë.

PASTRIM I SHTRATIT TË KANALEVE DHE PJERRËSIVE TË LUMIT VARDAR

Sipërfaqet e pjerrëta të bregut të lumit të Vardarit pastrohen rregullisht nga vegjetacioni i egër dhe nga mbeturinat.

Nga mbeturinat e hedhur dhe gjelbërimi i egër pastrohen edhe shtrati i lumit Lepenec, kanali Usjanski dhe kanalet në Przhino dhe Kozle.

Kanali i hapur Vodnjanski në vitin 2010 u mbulua, kurse për përmirësimin e funksionalitetit u mbulua kanali ujësjellës për liqenin në Parkun e qytetit.



PLAZHET E QYTETIT E GJALLËRUAN BREGUN E LUMIT

Plazhi i qytetit „Park“, në bregun e lumit Vardar, në vitin 2010 qytetarëve të Shkupit u mundësoi të freskohen dhe relaksohen në ditët e nxehta të verës. Projekti „Nga asfalti i nxehtë – direkt në plazh, një hap afër teje“ vizitorëve u ofroi rërë plazhi, shezlon, bar për pije, dushe, rekuizite për fëmijë dhe muzikë të mirë zbavitëse.



Në maj të vitit të kaluar Shkupi u bë edhe me plazhin e dytë. Plazhi „Ura e gurit“ është rregulluar në anën e majtë të bregut të lumit Vardar, ndërmjet urës „Goce Delçev“ dhe Urës së gurit. Në plazh janë vendosur streha dhe platforma druri, 20 tavolina, 80 shtylla dhe 80 shezlon. Dyshemeja e plazhit është me rërë të imët. Ka edhe katër banakë, kat për fëmijë me lëkundës, tribunë për mbajtjen e manifestimeve, dushe, dhoma për zhveshje, çezma uji, vende për parkimin e biçikletave dhe kosha për mbeturina.

Në ndërtimin e plazhit Qyteti i Shkupit investoi rreth 9 milion denarë, kurse në terren punuan ekipet e firmës ndërtimore „Alkon projekt“.

U ZGJAT KORSIA PËR PATINA NËPËR BREGUN E LUMIT VARDAR

Korsia për patina dhe biçikleta e cila në vitin 2010 u ndërtua nga qendra e qytetit deri te fabrika „Komuna“ gjatë vitit të kaluar u zgjat deri te ura „Bliznak“. Kjo pjesë e korsisë është e gjatë 2 338 metra, e gjerë 4 metra dhe është shtruar me asfalt.

Në ndërtimin e kësaj pjese të korsisë për patina-biçikleta në bregun e lumit punuan ekipet e fabrikës „Karposh“ dhe të NP „Rrugë dhe rrugica“. Qyteti i Shkupit për këtë punë ndërtimore shpenzoi rreth 7 milion denarë.



Nëpër bregun e lumit Vardar, nga ana e majtë, ekipet e Qytetit të Shkupit ndërtuan një pjesë të korsisë së patinave-biçikletave, në drejtimin nga bulevardi „Goce Delçev“ deri në bulevardin „8. Septemvri“. Korsia e re ka gjatësi 3 000 metra, është e asfaltuar dhe e shënuar.

Si pjesë e punëve ndërtimore të korsisë së re të patinave-biçikletave, nëpër gjatësinë e saj është ndërtuar mur mbështetës në pjesën ku nuk është rregulluar shtrati i lumit Vardar. Muri është i gjatë 80 metra, me lartësi të ndryshme nga 0 deri në 4 metra në varësi të konfiguracionit të terrenit.

Në ndërtimin e korsisë së re punuan ekipet e kompanisë së ndërtimit „Zhikol“ SHPKTHPV Strumicë. Për realizimin e këtij projekti Qyteti i Shkupit ndau rreth 16,5 milion denarë. Nëpër gjatësinë e korsisë është vendosur edhe ndriçim i ri rrugor.



LËRE AUTOMOBILIN, NGIT BIÇIKLETËN

Qytetarët e Shkupit nga data 1 prill do të huazojnë biçikleta për 10 denarë në orë në katër lokacione ekzistuese në qytet, përkatësisht në parkingun publik „Treska“, në parkingun publik në sheshin „Maqedonia“, në parkingun publik „Ilinden“ dhe në lagjen Aerodrom, tek Qendra tregtare „Biser“. Me kërkesë të shfrytëzuesve, në vijim janë përgatitjet për hapjen e punktut për huazimin e biçikletave tek Kopshti zoologjik.

Edhe gjatë këtij sezoni qytetarët biçikletën të cilën e kanë huazuar nga një stacion, mund ta kthejnë në tjetrin. Për shembull, nëse shfrytëzuesi ka huazuar biçikletën në stacionin në Aerodrom të njëjtën, mund ta kthejë në Aerodrom, mund ta kthejë në sheshin „Maqedonia“ ose, tek stacioni tek parkingu publik „Treska“.

Biçikletat mund të huazohen nga ora 7 deri në orën 21, kurse kthimi më së voni është deri në orën 23, çdo ditë, duke përfshirë këtu edhe të dielën.

Projekti për huazimin e biçikletave realizohet nën moton „Lëre automobilin, ngit biçikletën“, për të tretin vit me radhë.

Në funksion të promocionit të biçikletës si mjet transporti dhe rekreacioni Qyteti i Shkupit në periudhën e kaluar realizoi një numër të madh aktivitetesh: me ngjyrë të kuqe janë shënuar një numër i madh korsish për biçikleta, është vendosur lidhje e korsive të biçikletave nëpër bregun e lumit Vardar, është rinovuar dhe vendosur sinjalizim rrugor i ri horizontal dhe vertikal dhe janë vendosur mbajtëse për biçikleta. Qyteti i Shkupit apelon deri te qytetarët të sillen në mënyrë të ndërgjegjshme me biçikletat e huazuara.



MARATONA NDËRKOMBËTARE E SHKUPIT



Në rrugët e qytetit do të mbahen tre garat e Maratonës ndërkombëtare të Shkupit 2012. Sponsorë të këtij manifestimi tradicional sportiv janë Qyteti i Shkupit, Agjencia për të rinj dhe sport dhe Misioni i BE-së Shkup, organizatorë teknik janë Lidhja e sporteve të Shkupit dhe KA „Rabotnički“, kurse ko-organizator është federata e atletikës së Maqedonisë. Përveç ndihmës financiare Qyteti i Shkupit nëpërmjet ndërmarrjeve publike të tij ofron edhe ndihmë logjistike, kurse ndihmues të maratonës së Shkupit janë edhe Ministria e punëve të brendshme, Kryqi i kuq i Shkupit, Fakulteti i kulturës fizike dhe ARM.

Maratona e Shkupit është anëtar i AIMS (Asociacioni i maratonave dhe garave të rrugës) me Certifikatë të licencuar për korsi. Në suzat e maratonës së Shkupit do të mbahet Kampionati shtetëror nën organizimin e FMA.

Maratona e Shkupit këtë vit do të mbahet për herën gjashtë.

DY GARA NATE ME RASTIN E 13 NËNTORIT

Me rastin e 13 Nëntorit – Ditës së çlirimit të Shkupit nëpër rrugët e qytetit mbahen garat tradicionale të natës, gara e natës në atletikë dhe gara e natës në çiklizëm „Nëpër rrugët e Shkupit“.

Organizator i garës së natës në atletikë është Federata e atletikës e Maqedonisë, kurse i garës së natës në çiklizëm, Federata e çiklizmit të Maqedonisë. Sponsor i garave është Qyteti i Shkupit.



TURNË NË BOKS „GONGU I ARTË“

Turneu ndërkombëtar tradicional i boksit „Gongu i artë“ vitin e kaluar u mbajt për të 41-ën herë. Garuan boksierë nga 15 vende të botës ndërmjet të cilëve: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Bjellorusia, Italia, Romania, Çekia, Serbia, Sllovenia, Kroacia, Rusia, Moldavia, Tunizia, Spanja dhe Maqedonia.



TERRENE PËR VOLEJBOLL NË PLAZHET E QYTETIT

Në suazat e Plazhit të qytetit, Qyteti i Shkupit ndërtoi terrene volejboli me gjatësi nga 24 metra dhe gjerësi nga 14,5 metra. Terrenet kanë dysheme rëre me thellësi 40 centimetra, janë rrethuar me rrethim të lartë 6 metra dhe janë ndriçuar me reflektorë.

Në terrenet e plazhit „Park“ verën e kaluar u mbajt Turneu ndërkombëtar në volejboll në rërë „Shkupi 2011“. Turneu ishte nën organizimin e Qytetit të Shkupit dhe të Federatës së volejbollit të Republikës së Maqedonisë.

REKUIZITE SPORTIVE NË BREGUN E LUMIT

Qyteti i Shkupit në disa lokacione përgjatë bregut të lumit Vardar vendosi rekuizite sportive për stërvitje dhe rekreacion. Punte të tilla ka në plazhin e qytetit, tek ura „Bliznak“ në lagjen Aerodrom dhe tek hoteli „Aleksandar palac“.



„IKAS 2012“

Siloveni Brus Simon është fitues i edicionit të 44-ët të Sllallomit ndërkombëtar Ilinden në kanu - IKAS 2012 që nga 31 marsi deri më 1 prill u mbajt në korsi e lumit Treska në QRS „Matka“. Ai në disiplinën K-1 arriti rezultat 104.63.

Tek femrat në të njëjtën disiplinë fitoi Katerina Lukiçeva nga Kazakistani, e cila ishte më e mira në disiplinën C-1. Tek meshkujt në disiplinën C-1 rezultat më të mirë kishte Bllazh Zupan nga Sllovenia.

Në edicionin e sivjetmë të IKA morën pjesë 56 garues.

10 KLUBE EVROPIANE NBC NË BOULING 2011

Në qendrën sportive „Boris Trajkovski“ në tetor të vitit 2011 u mbajt turneu jubilar i 10-të i Klubeve evropiane NBC në bowling. Në turne morën pjesë rreth 500 garues nga 31 klube, nga pothuajse të gjitha vendet evropiane. Sponsor i këtij manifestimi sportiv ishte Qyteti i Shkupit, kurse organizator Federata e bowlingut e Maqedonisë.



U DHURUAN DY APARATE PËR HEMODIALIZË

Përveçat e Seksionit për nefrologji pranë Spitalit të përgjithshëm të qytetit „8. Shtatori“ dhe Institucionit publik shëndetësor „Hekurana“ Qyteti i Shkupit dhe komuna Qendër muajin e kaluar dhuruan 2 aparate për hemodializë për pacientët e sëmurë nga veshkat. Me vendim të Këshillit të Qytetit të Shkupit dhe komunës Qendër u siguruan 1.000.000, përkatësisht 200.000 denarë.


- Shoqata „Nefron“ realizoi furnizimin me aparate për hemodializë, kurse për furnizimin dhe shpërndarjen e aparateve morën pjesë aktive përfaqësues nga Qyteti i Shkupit, komuna Qendër, Fondi për shëndetësi, poliklinika „Hekurana“ poliklinika „Çair“ dhe Qendra për dializë Dijamed. Janë siguruar 2 aparate me çmim prej 1.180.000 denarë, të cilët i përmbushin plotësisht teknikat standarde dhe funksionale karakteristike.



PLATFORMË ASHENSORI PËR PERSONAT ME NEVOJA TË VEÇANTA

Në SHMQSH „Mihajlo Pupin“ në vitin 2010 u vendos platformë ashensori, e para dhe e vetme e këtij lloji në Maqedoni e cila është destinuar për persona që lëvizin me ndihmën e karrocës. Bëhet fjalë për platformë super moderne, panoramike, me hapje automatike të dverve dhe e pajisur me lidhe interfon. Me platformën sigurohet qasje deri te të gjitha katet e shkollës.

Drejtimi i platformës është me butona që janë adaptuar edhe për përdorimin nga persona të verbër, kurse për këtë qëllim nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2010 u ndanë rreth 2,5 milion denarë.



U PROVUA STRATEGJIA PËR BARAZI GJINORE

„Shkupi – qyteti i barazisë gjinore“ është titulli i Strategjisë për barazi gjinore të Qytetit të Shkupit që u promovua më 8 Mars. Strategjia përbën një dokument gjithëpërfshirës i cili shpreh politikën e Qytetit dhe planet për realizimin e vizionit të Shkupit për t'u transformuar në qytet me barazi gjinore.

3 AUTOMJETE PËR PERSONA ME INVALIDITET MË TË RËNDË

Qyteti i Shkupit lëshoi në përdorim automjete speciale të adaptuara për nevojat e personave me invaliditet më të rëndë. Tre automjetet janë pajisur me rampë për ngritjen e karrocës së invalidëve dhe pajisje të tjera që sigurojnë sigurinë e shfrytëzuesve.

Investimi i Qytetit të Shkupit është me vlerë rreth gjashtë milion denarë.

U ZGJERUA PUNKTI PËR TË PASTREHËT

U lëshua në përdorim një pjesë e punktut për të pastrehët e Kryqit të ku të qytetit të Shkupit në Momin Potok. Për realizimin e këtij projekti Qyteti i Shkupit ndau 1,4 milion denarë, kurse me hapjen e strehimores, kapacitetet e punktut u rritën për 60 metra katror. Ambienti i ri është pajisur me krevate, tualete, kuzhinë për çaj dhe mjete të tjera të domosdoshme gjë me të cilën do t'ju përgjigjet nevojave të këtyre personave.

Punktin në Momin Potok çdo ditë e vizitojnë deri në 20 të pastrehë, kurse ai funksionon më shumë se dy vjet.



U RINOVUA PUSHIMORJA NË QR „KATLANOVË“

Në vitin 2011 për rinovimin e pushimores në QR „Katlanovë“ Qyteti i Shkupit nga Buxheti ndau 350 000 denarë. Procesi i adaptimit të ambienteve për rekreacionin e pensionistëve në QR „Katlanovë“ do të vazhdojë edhe gjatë vitit në vijim.



HBO центар Скопје

QENDRA -OJQ

Qyteti i Shkupit hapi Qendrën – OJQ në ambientet e Qendrës kulturore rinore. Për qytetarët është i arritshëm edhe portali OJQ www.skopje.gov.mk/nvo

RIKONSTRUKSION I SHKOLLAVE TË MESME



Ekipet e Qytetit të Shkupit në vitin 2011 rinovuan objektet e 12 shkollave të mesme me qëllim përmirësimin e kushteve për punë të nxënësve dhe të të punësuarve. Për rikonstrukcionin Qyteti i Shkupit ndau një milion euro

Në shkolla u rinovuan nyjat sanitare, sipërfaqet e mureve dhe dysheveve, u zëvendësua zdrukthëtaria, çatitë dhe instalimi elektrik. Me këtë projekt u përfshinë shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit: „Mihajlo Pupin“, „Vlado Tasevski“, „Nikolla Karev“, „Zdravko Cvetkovski“, „Dimitar Vlahov“, „Vëllezërit Miladinov“, „Arsenij Jovkov“, „Pançe Arsovski“, „Zef Lush Marku“, „Rade Jovčevski–Korçagin“, „Georgi Dimitrov“ dhe „Orce Nikollov“.



Në 8 shkolla të mesme të Qytetit të Shkupit në vitin 2010 është realizuar rikonstrukcioni dhe riparimi i objekteve shkollore dhe sallave sportive. Në shkollat „Zdravko Cvetkovski“, „Pançe Arsovski“, „Arsenij Jovkov“, „Josip Broz-Tito“ dhe „Vlado Tasevski“ është zëvendësuar zdrukthëtaria, kurse në shkollat „8 Shtatori“, „Dimitar Vlahov“ dhe në „Muhajlo Pupin“ u rinovuan nyjat sanitare.

Në shkollat e mesme „Marija Kyri–Skłodovska“ u pajisën klasa të specializuara për degën e shëndetësisë për profilin arsimor laborant teknik dhe teknik mjekësor laborant.



LIGAT E SHKOLLAVE TË MESME

U mbajtën garat e Ligave në konkurrencën për femra dhe meshkuj ndërmjet ekipeve të shkollave të mesme në Shkup, në disa sporte në të dy konkurrencat dhe atë në futsal, hendboll, volejbol, basketboll, bouling, ping-pong, atletikë dhe volejbol në rërë.

„GJIMNAZIADA SHKUPI 2010“

Basketbolli, volejboli, hendbolli, futboli ishin sportet në të cilat matën fuqitë gjimnazistët e 48 ekipeve të shkollave të mesme nga e gjithë Maqedonia në „GJIMNAZIADA SHKUPI 2010“, të shtatë që u mbajt nga data 6 deri në datën 8 maj 2010 në Shkup.



MINI TERRENE ATLETIKE

Në oborrin e SHMQSH „Zdravko Cvetkovski“ është ndërtuar një mini terren atletike me korsi për vrapim sprint në 100 metra, korsi për kërcim së gjati dhe terren për hedhjen e gjyles.

Terrenin e ndërtuan ekipet e NP „Rrugë dhe rrugica“, kurse për këtë projekt Qyteti i Shkupit ndau 1,1 milion denarë.



Në shkollën e mesme „Arsenij Jovkov“ u ndërtuan mini terrene për sprint në 60 metra, trehapësh, kërcim së gjati dhe hedhje gjyleje.

Çdo shkollë e mesme e Qytetit të Shkupit mori 33 topa lëkure prej brendeve të njohura për praktikë dhe masivizimin e sporteve më popullore: basketboll, volejball, futboll dhe hendboll.



KUADRIL PËR FUNDIN E VITIT SHKOLLOR

Në fund të vitit shkollor në sheshin „Pela“ dhe në rrugën „11 Oktomvri“ maturantë nga shkollat e mesme të Shkupit do të vallëzojnë „Kudril“. Me këtë, maturantët përfshihen në manifestimin ndërkombëtar „Parada e maturës“.

TOLERANCË ZERO PËR DHUNËN NË SHKOLLË

Qyteti i Shkupit në shtator të vitit 2011 inicioi projektin „Zvogëlimi i dhunës dhe avancimi i sigurisë në shkollë – Tolerancë zero për dhunën në shkollë“ në të gjitha 21 shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit. Projekti ka për qëllim t'i trajtojë shkollat si të zhvillojnë politikat e shkollës, protokollet dhe programet për preventivë, të identifikojnë dhe të ballafaqohen me dhunën. Në

projektin në vijim janë përfshirë më shumë se njëqind mësues dhe punëtorë profesional të cilët punojnë në ekipe dhe vlerësojnë prioritetet e shkollave, organizojnë aktivitete në të cilat janë përfshirë nxënësit, prindërit, mësuesit dhe bashkësia lokale, dhe përmirësojnë klimën në shkollë, bashkëpunimin dhe i nxisin vlerat humane në bashkësinë shkollore.

Projekti përfundon në qershor të këtij viti.

PRESIDENTI I MALIT TË ZI, FILIP VUJANOVIQ - QYTETAR NDERI I SHKUPIT



Presidenti i Republikës së Malit të Zi, Filip Vujanović, në ceremoninë solemne, që u mbajt më 17 mars, u shpall qytetar nderi i Shkupit. Plakatin “Qytetar nderi i Shkupit” zotit Vujanović ia dha kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski.

- Presidenti Vujanović është mik i madh dhe respektues i Republikës së Maqedonisë dhe Shkupit, politikan bashkëkohor, burrë shteti i madh, humanist dhe promotor në ndërtimin e bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Malit të Zi dhe Republikës së Maqedonisë. Ai ka dhënë një kontribut të madh në krijimin e lidhjeve kulturore-historike dhe bashkëpunimit të frytshëm shumëvjeçar kulturor dhe ekonomik të shtetit malazez dhe maqedonas. Shpallja e Presidentit Vujanović qytetar nderi i Qytetit të Shkupit përbën respekt jo vetëm për presidentin malazez por edhe mirënjohje për përpjekjet paqedashëse të shtetit malazez në ndërtimin e bashkëjetesës ndëretnike në Republikën e Malit të Zi, në të cilën respektohen edhe qytetarët e saj maqedonas. Jam i bindur se titulli qytetar nderi do të kontribuojë për intensifikimin akoma më të madh të aktiviteteve në drejtim të fuqizimit të bashkëpunimit të dy vendeve tona dhe për thellimin e marrëdhënieve të dy qyteteve tona të vëllazëruara, Podgoricës dhe Shkupit –theksoi kryetari Trajanovski.

SHKUPI U VËLLAZËRUA ME ZAGREBIN...

Me nënshkrimin e Kartës për miqësi dhe bashkëpunim ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Zagrebit, nga kryetarët Koce Trajanovski dhe Millan Batiq, Shkupi dhe Zagrebi u bënë qytete të vëllazëruara. Qëllimi i kësaj Karte është që t’u mundësohet qytetarëve të të dy qyteteve realizimi i qëllimeve të përbashkëta dhe rezultateve, si dhe fuqizimi i lidhjeve ekzistuese, me theks të veçantë në zgjerimin e lidhjeve ekonomike dhe kulturore; këmbimin e eksperiencave në programet ekologjike, veçanërisht në mbrojtjen e ambientit jetësor; njohjen e ndërsjellët të kulturës, historisë dhe traditës; bashkëpunimin ndërmjet muzeve, universiteteve; bashkëpunimin multikulturor dhe fuqizimin e lidhjeve ndërmjet pakicave kombëtare; projektet e BE-së; arsimin (bashkëpunimi ndërmjet shkollave të mesme); urbanizmin dhe bashkëpunimin ndërmjet ndërmarrjeve publike.

Zagrebi është qyteti i shtatëmbëdhjetë me të cilin është vëllazëruar Shkupi.

...DHE ME BEOGRADIN

Qyteti i Shkupit më 26 mars u vëllazërua me Qytetin e Beogradit. Marrëveshjen për vëllazërim ndërmjet të dy qyteteve në Beograd e nënshkruan kryetarët Koce Trajanovski dhe Dragan Gjilas. Në takim të dy kryetarët biseduan për shumë tema nga fusha e jetës urbane, komunikacionit, planifikimit urbanistik, mirëmbajtjes së higjienës, zhvillimit të arsimit, përkrahjes për kulturën dhe sportin.

Shkupi dhe Beogradi përvite mer radhë kanë bashkëpunim të afërt, kurse me vëllazërimin e dy qyteteve hapet mundësi akoma më e madhe për këmbimin e eksperiencave dhe bashkëpunimit në shumë fusha të jetës shoqërore, veçanërisht për zgjidhjen e problemeve të komunikacionit rrugor, çështje të urbanizmit dhe zhvillimit të arsimit.





ÇMIMI „KARTA BALLKANIKE E PAQES“

Organizata ndërkombëtare joqeveritare „Klubi ballkanik i paqes“ më 21 janar i ndau Qytetit të Shkupit çmimin „Karta ballkanike e paqes“. Bëhet fjalë për mirënjohjen e parë të këtij lloji, e cila është vendosur më 6 mars të vitit 2010 në takimin në Kotor, kurse e njëjta i jepet Qytetit të Shkupit për meritat e tij dhe aktivitetet për zgjerimin e ideve të paqes dhe miqësisë, si në Ballkan, ashtu edhe më gjerë.

„BIENALE E ARTISTËVE TË RINJ NGA EVROPA DHE NGA MESDHEU“

Qyteti i Shkupit nga data 3 deri në datën 12 shtator 2009 ishte nikoqir i manifestimit kulturor „Bienale e artistëve të rinj nga Evropa dhe Mesdheu“. Pas Barcelonës, Selanikut, Marsejës, Valencias, Lisbonës, Torinos, Romës, Sarajevës, Napolit dhe Punjës, kryeqyteti i Maqedonisë për herë të parë kishte mundësinë që të jetë nikoqir i një prej evenimenteve më të mëdha kulturore në Evropë. Nëntë ditë në Shkup rreth 800 artistë, të moshës nga 18 deri në 30 vjet, krijuan në shtatë disiplina artistike – arte vizuale, art interpretues, performanca, literaturë, muzikë, gastronomi dhe art filmik. Artistët erdhën nga 48 vende të Ballkanit, Lindje së Mesme, Mesdheu dhe nga vendet anëtare të BE-së.



PANAIRI I VENDEVE FRANKOFONE

Qyteti i Shkupit me stendën e tij mori pjesë në PANAIRIN E VENDEVE FRANKOFONE që u mbajt më 31 mars të këtij vitit në Qendrën vero në Shkup. Panairi u mbajt në suazat e Muajit të frankonisë, kurse organizator i manifestimeve ishte Instituti i frankonisë në Shkup.

Qyteti i Shkupit në vitet e kaluara ka marrë pjesë në Panair si qytet i vëllazëruar me qytete Dizhon,, Rube dhe Varem.



U HAP PËRSËRI KINEMAJA „MILENIUM“

Kinemaja „Milenium“ në fund të vitit 2009 hapi përsëri dyert për adhuruesit e filmit. Në repertorin e kinemasë mund të shikohen hite filmike botërore nga produksioni më i ri.

Iniciativa për marrjen dhe hapjen e sërishme të kinemasë „Milenium“ është e kryetarit të Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski.



3D TEKNOLOGJI NË KINEMANË E QYTETIT „MILENIUM“

Adhuruesit e artit të shtatë nga muaji i kaluar në Kinemanë qytetit „Milenium“ mund të kënaqen me projeksionet me pajisjet më aktuale dhe më moderne të tregut botëror 3D. Teknologjia e re 3D e instaluar në „Milenium“ u promovua me premierën e filmit dokumentar njëqind minuta të gjatë „Pina“, të punuar sipas skenarit dhe regjisë të regjisorit të famshëm Uim Uenders.

Për realizimin e projektit për pajimin e kinemasë „Milenium“, me teknologjinë më të re dhe më të sofistikuar 3D, nga Buxheti i Qytetit të Shkupit u ndanë rreth 8.500.000 denarë, kurse biletat për projeksionet 3D do të kushtojnë 200 denarë dhe mund të blihen në sportelin e Kinemasë së qytetit Milenium, çdo ditë nga ora 10:30 deri në orën 22:30.

U VENDOSËN 11 TEZGA PËR LIBRA

Në rrugën „Maqedonia“ dhe në sheshin „Maqedonia“ janë vendosur 11 tezga stilistike të unifikuara, të destinuara për shitjen e librave dhe të publikimeve të botuara.



17 PANO MODERNE TURISTIKE

Qyteti i Shkupit vendosi 17 pano dyanëshe reklamuese, me 34 harta tre dimensionale në të cilat janë paraqitur vendet më të rëndësishme të qytetit tonë. Hartat janë në tre gjuhë (maqedonisht, shqip dhe anglisht) dhe paraqesin regjionin me legjenda dhe me informacione për institucionet e rëndësishme dhe monumentet e tjera për qytetin e Shkupit.

Bilbordet janë vendosur në lokacione të ndryshme në territorin e qendrës së qytetit.

KAFJALL NË URË

Në Urën e gurit nga fundi i shtatorit u mbajt manifestimi i qytetit „Kafjall në urë”. Në urë u vendosën stenda dhe tavolina me ushqim dhe me pije nga shumë prodhues maqedonas, kurse prodhimet e tyre kishin mundësi t'i shijojnë mbi 2 000 qytetarë.

Ky manifestim deri tani është mbajtur dy herë.



MANIFESTIMI PËR FËMIJË „VALLE PA KUFIJ”

Nga data 23 deri më 25 shtator shkupanët kishin mundësi të dëgjojnë këngë, muzikë, vallëzime dhe veshje kombëtare të pasura me të cilat u përfaqësuan fëmijët nga Polonia, Turqia, Bullgaria, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina dhe nga Maqedonia si pjesë e festivalit më masiv dhe më të vjetër për fëmijë „Valle pa kufij”. Festivali është nën organizimin e Qendrës kulturore për fëmijë „Karposh” dhe në vitin 2011 festoi jubileun e 20-të.



DITË TË ARTIZANATIT

Në suazat e manifestimit tradicional të qytetit Ditë të artizanatit në Republikën e Maqedonisë më 30 shtator të vitit 2011 Dhoma e artizanatit e Shkupit kryetarit të Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski i ndau pllakatin për përmirësimin e kushteve të përgjithshme për zhvillimin dhe avancimin e artizanatit.

Qyteti i Shkupit deri tani ka realizuar shumë projekte për zhvillimin dhe avancimin e artizanatit, siç janë: Formimi i poligonit të qendrave për trajnim, Qendra për industri kreative - Shkup, Qyteti i zanateve të lashta, Qyteti i punimeve të dorës, artistëve dhe artizanalëve, Tingujt e çarshisë, Panairi i pranverës dhe i Vitit të Ri, Hotelieri më i mirë ndërmjet më të mirëve, Fundjava e lakmuesve në Shkup, Festivali i verës, Tortijada ndërkombëtare, Festivali i ushqimit organik dhe Muaji i tregtisë.



„Vinoskop 2011“



„MOT 2011“



„Pivolend 2011“



„Koloni e arteve figurative 2010“



„Baskerfest 2009“



„Nata e bardhë“



„45 vjet Salla universale“



„Vera e Shkupit 2010“